



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më

_____.____.2023

VENDIM

Nr. 536, datë 12.10.2023

**PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR
PERIUDHËN 2020 - 2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2020- 2022”, i hartuar nga relatores znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares {...}, për periudhën 2020- 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, Gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes apo natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale gjatë fazës së ekzekutimit) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar “*Procedura*”, në të cilën përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes.

Kështu, në vendimet e arsyetuara si Gjyqtar i Seancës Paraprake me objekt: “*Pushim procedimi penal*” dhe “*Dërgim në gjyq*”,¹ gjyqtarja evidenton ecurinë procedurale që lidhet me njoftimet e palëve dhe praninë apo mungesën e tyre në gjykim; paraqitjen apo mungesën e kërkesave për pavlefshmëri apo papërdorshmëri; masat e marra nga gjyqtarja për të garantuar drejtësinë miqësore për të miturit.² Po ashtu, në gjykimet civile me objekt: “*Pavlefshmëri titulli ekzekutiv*” pasqyrohet ecuria e procesit gjyqësor dhe vijimi i gjykimit në fazën ku është ndërprerë nga trupi i mëparshëm gjykues në veprime paraprake dhe seancë përgatitore.³ Megjithatë, ka raste që ecuria procedurale është e integruar në pjesën e “Rrethanave të faktit”. Kështu, në çështjet me objekt “*Zgjidhje martese*” evidentohen aspekte procedurale si njoftimet e palëve dhe kryerja e veprimeve të pajtimit në çështjet me objekt: “*Zgjidhje martese*”⁴ është e integruar nën rubrikën

“*Rrethanat e çështjes*”. Po ashtu, nën këtë emërtim “*Rrethanat e çështjes*”, evidentohen aspekte procedurale në çështjet e arsyetuara si gjyqtari i zgjidhjes në themel të çështjes penale, ku përshkruhet kërkesa e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq;⁵ veprimet e kryera me qëllim zgjidhjen e çështjes me marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit;⁶ ecuria e hetimit penal në çështjet me objekt “*Zëvendësim mase sigurimi*”.⁷

Në një nga çështjet civile objekt shqyrtimi, referuar natyrës së vendimit, gjyqtarja është ndalur vetëm në pasqyrimin dhe analizën e fakteve me natyrë procedurale, që lidhen me përmbajtjen e kërkesëpadisë dhe akteve që shoqërojnë atë, të cilat duke mos u paraqitur në formën e duhur procedurale, përcaktuar kjo nga natyra e vendimit gjyqësor, i cili është vendim për kthimin e padisë me të meta.⁸

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (*penale, civile ose familjare*) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë,

¹Vendim nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2020-255, datë 12.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2021-61, datë 02.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-159, datë 19.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

²Vendim nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

³Vendim nr. 52-2022-123, datë 28.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁴Vendim nr. 52-2020-150 datë 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2020-97, datë 10.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-211, datë 24.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁵Vendim nr. 52-2022-226 datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-90 datë 17.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁶Vendim nr. 52-2021-77 datë 17.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁷Vendim nr. 52-2020-195 datë 23.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

⁸Vendim nr. 52-2020-296, datë 17.11.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar apo i zakonshëm në çështjet penale*), zhvillimi i gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, faza në të cilën ka vijuar gjyqtari në rastet e ndryshimit të trupit gjykues, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje përgjithësisht të titulluar “*Rrethanat e faktit*”, duke i sqaruar ato në mënyrë të qartë, në një rend kronologjik dhe logjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtarja ka konkluduar lidhur me provueshmërinë e fakteve konkrete. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtarës lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

- Në çështjet me objekt: “*Zgjidhje martesë*” gjyqtarja përshkruan rrethanat e faktit në mënyrë kronologjike duke sqaruar datën kur është lidhur martesa, faktin se nga martesa kanë lindur fëmijë, faktin se cili është shkaku i kërkesës për zgjidhje martesë, duke integruar provat, prej të cilave rezultojnë ato në mënyrë të detajuar, si dhe pretendimet e qëndrimet e palëve të shprehura në seancë pajtimi, gjatë gjykimit dhe bisedime përfundimtare.
- Në çështjet civile të përgjithshme me palë kundërshtare, gjyqtarja përshkruan rrethanat e faktit duke integruar dhe provat prej të cilave rezultojnë ato, ku rezulton se sqarohet arsyeja përse pala paditëse i është drejtuar gjykatës.
- Në çështjet penale themeli apo në seancë paraprake (*me objekt “Pushim procedimi penal” apo “Dërgim në gjyq”*), gjyqtarja specifikon rrethanat e çështjes përmes tregimit të vendit, datës, orës, mënyrës, autorit, të integruara këto rrethanat me provat prej të cilave rezultojnë ato. Provat sqarohen me detaje duke përcaktuar burimin e tyre, aktin procedural, përmbajtjen e plotë dhe datën e përpilimit (*procesverbal këqyrje të vendit të ngjarjes, procesverbal për verifikimin e deklarimeve, akt ekspertimi, procesverbal sekuestrimi*).

- Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Gjyqtarja, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi, njohje e vërtetësisë së dokumentit, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, padi për njohje pronar me parashkrim fitues*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj, dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën procedohet në çështjet penale, apo seancën paraprake nëse jemi para një kërkesë dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkaktit dhe objektit të padisë, posaçërisht në çështjet civile, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar ligjin e zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit, dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

- Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenin 61 të K.Pr.Civile lidhur me kompetencën lëndore dhe ngritjen kryesisht të saj; nenet 17, 7 të Ligjit nr. 49/2012 lidhur me kompetencën e gjykatës administrative;⁹
- nenet 2, 5, 16/1, 17, 9, 180, 185, 31, 154, 185 të K.Pr.Civile, në lidhje me identifikimin e objektit të padisë,¹⁰ cilësimin juridik të fakteve dhe vendimin e ndërmjetëm për saktësimin e objektit të padisë;¹¹
- nenin 59 të K.Pr.Civile, lidhur me juridiksionin; nenet 36, 41, 45 të K.Pr.Civile dhe nenet 169, 170 të K.Civil lidhur me kompetencën nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për çështjet me objekt pasuri të paluajtshme;¹²
- nenet 71, 72, 73 të K.Pr.Civile lidhur me mungesën e shkaqeve të papajtueshmërisë ose përjashtimit të gjyqtarës;¹³
- nenin 253, 254 të K.Pr.Civile lidhur me aktet zyrtare; nenin 231, 232 të K.Pr.Civile lidhur me provën me dëshmitarë;¹⁴
- nenet 31 dhe 32 të K.Pr.Civile lidhur me të drejtën e ngritjes së padisë dhe rasteve;¹⁵
- nenet 36/1, 41, 51 të K.Pr.Civile lidhur me kompetencën e gjykatës në çështjet me objekt zgjidhje martesë; nenin 134 të Kodit të Familjes në lidhje me seancën e pajtimit;¹⁶
- nenin 317 të K.Pr.Civile sa i takon dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm për pjesën e detyrimit për ushqim dhe edukimin e fëmijëve;¹⁷

⁹Vendim nr. 52-2021-48, datë 22.02.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹⁰Po aty

¹¹Vendim nr. 52-2020-168 (52), datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹²Po aty

¹³Vendim nr. 52-2020-168 (52), datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendimin nr. 52-2022-123, datë 28.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹⁴Vendim nr. 52-2020-168 (52), datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendimin nr. 52-2020-202, datë 28.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹⁵Po aty

¹⁶Vendim nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendimet nr. 52-2020-97, datë 10.03.2020, dhe nr. 52-2022-211, datë 24.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

- nenin 107 të K.Pr.Civile lidhur me pagesën e shpenzimeve gjyqësore;¹⁸
- nenin 2 të K.Pr.Civile lidhur me parimin e disponibilitetit të padisë; nenin 154 të K.Pr.Civile, lidhur me formën që duhet të ketë kërkesa/kërkesëpapia; nenet 154/a, nenin 156 të K.Pr.Civile lidhur me pasojën juridike procedurale në rast se nuk piqen kriteret e ligjit procedural;¹⁹
- nenet 609, 610, 612-614 të K.Pr.Civile si mjetet për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.²⁰

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*seancës paraprake, gjykim themeli apo kërkesë penale në fazën e ekzekutimit*), apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- 69, 74, 76 të K.Pr.Penale në lidhje me juridiksionin, kompetencën dhe mungesën e shkaqeve të papajtueshmërisë apo përjashtimit nga gjykimi të gjyqtarës;
- nenet 128/a, 332/dh pika 1/c, 405, 403/2 të K.Pr.Penale lidhur me mungesën e akteve absolutisht të pavlefshme dhe pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nga Gjyqtari i Seancës Paraprake;²¹
- nenet 13/2, 15, 16, 17, 18, 69, 74, 76 të K.Pr.Penale lidhur me juridiksionin, kompetencën dhe mungesën e shkaqeve të papajtueshmërisë apo përjashtimit;
- citon nenet 328, 329/a dhe 329/b të K.Pr.Penale, sa i përket zhvillimit të procedurës në seancë paraprake dhe njoftimin e viktimave si dhe në lidhje me rastet e pushimit të akuzës ose çështjes dhe kërkesës për pushimin e akuzës ose çështjes;
- nenet 253/1 të K.Pr.Penale dhe nenin 86 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur lidhur me ndalimin e ligjshëm të të miturit në konflikt me ligjin;²²
- nenin 228 të K.Pr.Penale lidhur me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme që duhet të plotësohen për të caktuar një masë sigurimi personal; citon nenet 229 -230 të K.Pr.Penale në lidhje me kriteret e veçanta dhe përshtatshmërinë e masës së kërkuar nga prokurori;²³
- nenet 331, 327, 332, 332/a, 332/ë/1 të K.Pr.Penale lidhur me elementët formal që duhet të përmbajë kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq; pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, njoftimet dhe caktimin e seancës paraprake, dhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit;²⁴
- nenin 18 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur në lidhje me praninë e psikologut në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin si subjekt i detyrueshëm;²⁵
- nenin 332/ç të K.Pr.Penale lidhur me vendimin për plotësimin e hetimeve të Gjyqtarit të Seancës Paraprake, për të sqaruar ecurinë procedurale të çështjes;²⁶
- nenin 128 të K.Pr.Penale lidhur me pavlefshmërinë absolute të akteve, nenet 332, 332/a, 331, 327, 332/ë/1 të K.Pr.Penale lidhur me procedurën e zbatueshme në

¹⁷Vendim nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹⁸Vendim nr. 52-2020-202, datë 28.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-123, datë 28.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹⁹Vendim nr. 52-2020-296, datë 17.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

²⁰Vendim nr. 52-2022-123, datë 28.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

²¹Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

²²Vendim nr. 52-2022-100, datë 31.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

²³Po aty

²⁴Vendim nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

²⁵Po aty

²⁶Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

seancë paraprake, përmbajtjen e kërkesës për dërgimin e çështjes penale në gjyq, pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, përmbajtja e fashikullit të gjykimit;²⁷

- nenin 190/1 të K.Pr.Penale në lidhje me disponimin mbi provat materiale të sekuestruara;
- nenin 260/2 të K.Pr.Penale në lidhje me rastet e zbutjes së masës së sigurimit personal; nenin 260/3 të K.Pr.Penale në lidhje me rëndimin e masës së sigurimit personal; nenet 229 -230 të K.Pr.Penale në lidhje me kriteret e veçanta dhe përshtatshmërinë e masës së kërkuar nga Prokurori; nenin 228 të K.Pr.Penale, në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të caktimit të masës së sigurimit personal;²⁸
- nenin 406/d, 406/dh, 406/e, 406/f të K.Pr.Penale, në lidhje me një nga format e gjykimeve të posaçme, gjykimin me marrëveshje, respektivisht “përmbajtja e marrëveshjes”; “shqyrtimi nga gjykata”; “miratimi i marrëveshjes”; “ankimi ndaj vendimit të gjykatës”;²⁹
- identifikon normat procedurale të posaçme në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin sa i përket kufizimit të lirisë së tyre, konkretisht nenet 15, 86 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, për të ligjëruar vendimmarrjen mbi masën e sigurimit personal të caktuar.³⁰

Megjithatë, në një prej vendimeve me të mitur në konflikt me ligjin,³¹ nuk vihet re që të jenë identifikuar dhe zbatuar nenet 22 e 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur³² që parashikojnë hartimin e një Raporti Vlerësimi Individual, si detyrim ligjor në procesin penal me të mitur.³³

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, i cili gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt

²⁷Vendim nr. 52-2020-255, datë 12.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

²⁸Vendim nr. 52-2020-195 (A 19), datë 23.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

²⁹Vendim nr. 52-2021-77 (4), datë 17.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

³⁰Vendim nr. 52-2022-100, datë 31.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

³¹Vendimi nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

³²Neni 22 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon se: “1. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, organi që administron procesin e trajton të miturin me kujdes dhe vëmendje të veçantë. 2. Në çdo vendimmarrje në lidhje me të miturin, merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: mosha, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual. 3. Gjykata/prokurori, përpara marrjes së ndonjë vendimi mbi të miturin, thërret, sipas rastit, një ekspert ose grup ekspertësh të disiplinave të ndryshme për vlerësimin e rrethanave individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit në mënyrë që të kuptojë personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij...”. Neni 47 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur ndër të tjera parashikon se “1. Prokurori/gjykata në procesin e vlerësimit të të miturit mbështetet në nivelin e zhvillimit, mënyrën e jetesës, edukimin dhe kushtet e zhvillimit, arsimimin, gjendjen shëndetësore, mjedisin familjar dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta...”.

³³Neni 55 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon ndër të tjera se: “1. Organi kompetent në çdo rast vlerëson marrjen e masës së shmangies ndaj të miturit në konflikt me ligjin”.

vlerësimi në dy kategori:(i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

Në vendimet civile (me objekt: detyrimin e njohjes pronar me parashkrim fitues; zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj; vërtetimin e qenies në marrëdhënie pune; pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, etj.) gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Familjes, ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, konkretisht:

- Në padinë me objekt *“Detyrimin e njohjes pronar me parashkrim fitues”*, gjyqtarja identifikon nenet 83, 92, 149, 163, 164, 168, 169, 170, 191, 193, 304, 305, 705, 253 të K.Civil; Ligji nr. 7843 datë 13.07.1994 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”* (neni 24); VKM nr. 503 datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave.
- Në paditë me objekt *“Zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj”*, gjyqtarja identifikon: nenet 1, 50, 51, 55, 123, 132, 146, 155, 156, 157, 158, 161, 197, 201 të Kodit të Familjes në lidhje me institutin e martesës, detyrimet që lidhin nga martesë, rastet e zgjidhjes së martesës, shkaqet kur kërkohet zgjidhja e martesës, pasojat në lidhje me zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve sa i takon mbiemrit, fëmijëve (lënia e tyre për rritje dhe edukim, përcaktimi i mënyrës së ushtrimit të së drejtës për takim, caktimi i detyrimit për ushqim për fëmijë); citon nenin 232 të Kodit të Familjes në lidhje me moslegjitimimin aktiv të prindit për kërkimin e detyrimit për ushqim për fëmijën madhor.
- Në padinë me objekt *“Vërtetimin e qenies në marrëdhënie pune”* gjyqtarja trajton nenin 32 të K.Pr.Civile në lidhje me rastet kur mund të ngrihet një padi.
- Në padinë me objekt *“Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv”*, gjyqtarja identifikon nenet 609, 610, 612-614 të K.Pr.Civile, si mjetet e parashikuara për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, citon nenet 341 të Kodit Civil mbi detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore dhe nenin 520 të K.Pr.Civile, efektet e urdhrit të ekzekutimit ndaj trashëgimtarëve. Citon nenet 510, 510/e të K.Pr.Civile; nenin 1 të Ligjit nr. 8662, datë 18.09.2000 *“Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”*, pikën 9 të nenit 77 të Ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, nenet 6, 9, 11 të Vendimit nr. 232 datë 20.12.2019 të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike lidhur me faktin nëse fatura objekt kundërshtimi përbën titull ekzekutivi.

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Familjes dhe ligjeve të posaçme si më sipër, Gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si më poshtë:

- nenin 53 të Kushtetutës, nenet 8/1, 12 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me të drejtën për jetë familjare;³⁴ (padi të me objekt zgjidhje martesë)
- nenet 11, 41, 42 të Kushtetutës, nenin 1 Protokollin 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me të drejtën e pronës³⁵ (padi me objekt njohje pronar me parashkrim fitues).

³⁴Vendimet nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020, nr. 52-2020-97, datë 10.03.2020, dhe nr. 52-2022-211, datë 24.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

³⁵Vendim nr. 52-2020-168 (52), datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit si dhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, si më poshtë:

- Identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal dhe analizës së elementëve të figurës së veprës penale:
- nenet 76 e 22, 279/2, 236/1 të K.Penal lidhur me figurat e veprave penale të *“Vrasjes me dashje”* e mbetur në tentativë, *“Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”*, *“Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”*;³⁶
- nenin 88 të K.Penal lidhur me figurën e veprës penale të *“Plagosjes së rëndë me dashje”*;³⁷
- nenet 140 dhe 278 të Kodit Penal në lidhje me rastet figurat e veprave penale si *“Vjedhje me armë”*, *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe muncionit”* duke analizuar kohën e nevojshme për parashkrimin e këtyre figurave të veprave penale;³⁸
- nenin 134 të Kodit Penal³⁹ lidhur me figurën e veprës penale të *“Vjedhjes”* duke e analizuar kohën e nevojshme për parashkrimin e kësaj figure të veprës penale.
- nenin 283/2 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të *“Prodhimi i lëndëve narkotike”*;⁴⁰
- nenin 291 të Kodit Penal, në lidhje me figurën e veprës penale të *“Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”* dhe duke qenë një dispozitë blankete, referon në nenet 53-54, 115 të Kodit Rrugor dhe VKM nr. 153 datë 07.04.2000 *“Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”* si norma të posaçme rregullative;⁴¹
- nenin 277 të Kodit Penal lidhur me kryerjen e veprës penale të *“Vetëgjyqësisë”*;⁴²
- nenet 102/1 e 22 të K.Penal lidhur me figurën e veprës penale të *“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”* e mbetur në tentativë;⁴³
- nenin 186 të Kodit Penal në lidhje me figurën e veprës penale të *“Falsifikimit të dokumenteve”*.⁴⁴

Referohen dispozita pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht: nenin 15 të K.Penal në lidhje me dashjen si formë fajti;⁴⁵ nenin 12 të K.Penal lidhur me moshën për përgjegjësinë penale dhe nenin 17 të K.Penal lidhur me përgjegjshmëri mendore;⁴⁶ nenet 47, 48/ç, 49, 50 të K.Penal në lidhje me individualizimin e dënimit;⁴⁷ nenin 59 të

³⁶Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

³⁷Po aty

³⁸Vendim nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

³⁹Vendim nr. 52-2021-61, datë 02.03.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴⁰Vendim nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴¹Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2021-77 (4), datë 17.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴²Vendim nr. 52-2020-255, datë 12.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴³Vendim nr. 52-2022-90, datë 17.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴⁴Vendim nr. 52-2022-159, datë 19.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴⁵Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴⁶Po aty

⁴⁷Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-90, datë 17.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

K.Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë,⁴⁸nenin 55 të K.Penal në lidhje me bashkimin e dënimeve, etj.

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 21 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi mbrojtjen e të drejtës së jetës;⁴⁹
- nenet 27 të Kushtetutës, nenin 5 të KEDNJ lidhur me kufizimin e lirisë së personit.⁵⁰

Sa i përket konfliktit të normave, nga tërësia e vendimeve gjyqësore burim vlerësimi nuk konstatohet ndonjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, gjyqtarja shfaq përgjithësisht aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes së plotë të fakteve të çështjes. Në faktet me natyrë procedurale jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve. Edhe faktet thelbësore të çështjes, paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, të integruar provat e administruara në gjykim. Normat konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, identifikohen, citohen dhe analizohen e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Përcaktimi i qartë i natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizën ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me

⁴⁸Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁴⁹Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁵⁰Vendim nr. 52-2020-195 (A 19), datë 23.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Gjyqtarja i kushton vëmendje interpretimit të normave në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin *teologjik*, duke identifikuar qëllimin e normës, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përqasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, duke e analizuar më pas normën në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se:

- Duke interpretuar nenet 168, 169 dhe 170 të K.Civil lidhur me legjitimitetin aktiv dhe pasiv në padinë për fitimin me parashkrim fitues të pasurisë, gjyqtarja analizon se paditësi kur ngre padinë duhet ta ketë shumë të qartë që i paditur është pikërisht pronari i mëparshëm i sendit. Lidhur me legjitimitetin pasiv të Bashkisë Pukë dhe Këshillit të Ministrave i referohet VKM nr. 503 datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave dhe Ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i cili ndan pronat e paluajtshme të shtetit në dy grupe: prona të paluajtshme të pushtetit qendror dhe prona të paluajtshme të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe se është Këshilli i Ministrave që përcakton organin shtetëror përgjegjës për administrimin e çdo njësie të pronës së paluajtshme shtetërore. Në këtë linjë, gjyqtarja vijon analizën e neneve 168 dhe 169 të Kodit Civil, ku arsyetohet se elementët kryesorë të parashkrimit fitues janë: posedimi, kohëzgjatja e posedimit dhe mungesa e ushtrimit të tagrave të pronësisë së pronarit. Po ashtu, trajtohet natyra e padisë dhe vendimit mbi fitimin me parashkrim fitues të pasurisë, si një padi me karakter njohje, deklarativ. Gjyqtarja interpreton në aspektin historik institutin e parashkrimit fitues pa titull, ku sqarohet se nuk parashikohej në Kodin Civil të miratuar me Ligjin nr. 6340 datë 26.06.1981, ndërsa instituti i parashkrimit fitues me titull ka qenë i parashikuar në Dekretin nr. 2083 datë 06.07.1956 “Mbi pronësinë”, si dhe nga Kodi Civil i vitit 1982, për të konkluduar se me hyrjen në fuqi të Kodit Civil aktual më datë 01.11.1994 kanë hyrë në fuqi dispozitat që rregullojnë institutin e parashkrimit fitues (nenet 168-171 të K.Civil). Gjyqtarja interpreton literalisht dhe sistematikisht nenet 1163 të K.Civil dhe nenit 169 të tij për të konkluduar se parashkrimi fitues pa titull mund të pretendohet vetëm për posedim të qetë e të pandërprerë të sendit prej 20 vjetësh duke filluar të ecë ky afat nga dita e hyrjes në fuqi të K.Civil, pra 01.11.1994. Po ashtu, përmes interpretimit të neneve 92, 83 të K.Civil dhe nenit 231 i K.Pr.Civile arrihet në përfundimin se veprimi juridik për kalimin e pronësisë kërkon formën noteriale, mungesa e të cilit sjell pavlefshmërinë absolute të tij. Po në funksion të kësaj analize, gjyqtarja merr në analizë kriteret e nenit 169 të K.Civil duke përcaktuar se duhet të ekzistojnë dy kushte kumulative: posedimi i qetë, pa ndërprerje e sjellje si pronar dhe kalimi i afatit 20 vjeçar. Më tej, jepen dhe shpjegohen kuptimi i “*posedimit*”, “*posedimit*

*në mirëbesim”, “posedimi i vazhdueshëm e i pandërprerë”, “momenti i hyrjes në posedim – llogaritja e afatit”.*⁵¹

- Duke interpretuar literalisht, teleologjikisht dhe sistematikisht nenet 1, 50 dhe 132 të Kodit të Familjes, gjyqtarja dedukton se ekzistenca e martesës si një marrëdhënie juridike dhe vazhdimësia e saj kërkon pëlqimin dhe vullnetin e lirë të palëve jo vetëm në momentin e lidhjes së saj, por edhe gjatë vazhdimësisë së saj. Mungesa e këtij vullneti pasjellë lindjen e mundësisë për të zgjidhur martesën. Në këtë linjë, arsyetohet se shkaqet e zgjidhjes së martesës, të përcaktuara në nenin 132 të Kodit të Familjes, konkretisht grindjet e vazhdueshme, keqtrajtimet, fyerjet e rënda, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, sëmundja mendore e pashërueshme, dënimi penal i rëndë dhe çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesë, jeta e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin e saj. Gjyqtarja i analizon këto shkaqe si listë joshteruese, por orientuese. Gjyqtarja merr në analizë të detajuar konceptet e pamundësisë së jetesës së përbashkët e humbjes së qëllimit për martesë për bashkëshortët si dhe lidhjes shkakësore midis shkakut për të cilin kërkohet zgjidhja e martesës dhe pamundësisë së jetesës së përbashkët. Në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës, gjyqtarja interpreton nenin 146 të Kodit të Familjes (rimarrja e mbiemrit), nenin 158 të Kodit të Familjes, për të analizuar mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në rastet kur prindërit jetojnë të veçuar, të cilin gjyqtarja e emëron “Plani i prindërimit” dhe rregullimin e tij e gjen në një sërë dispozitash të Kodit të Familjes, si dhe nenin 201 të Kodit të Familjes (detyrimi për ushqim). Në këtë linjë, interpreton nenin 232 të Kodit të Familjes në lidhje me moslegjitimimin aktiv të prindit për kërkimin e detyrimit për ushqim për fëmijën madhor.⁵²
- Duke interpretuar nenet 609, 610, 612-614 të K.Pr.Civile si mjetet e parashikuara për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, i kushtohet një trajtesë e veçantë dhe e detajuar e padisë së “Pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv”, padi e cila parashikohet në nenin 609 të K.Pr.Civile. Gjyqtarja trajton titullin ekzekutiv si koncept juridik dhe shkakun ligjor të padisë së pavlefshmërisë së titullit juridik. Në këtë linjë arsyetimi, citon nenin 341 të Kodit Civil lidhur me detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore dhe nenin 520 të K.Pr.Civile, efektet e urdhrit të ekzekutimit ndaj trashëgimtarëve, për të konkluduar mbi legjitimimin aktiv të paditëses. Në vijim, citon nenet 510, 510/e të K.Pr.Civile; nenin 1 të Ligjit nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, pikën 9 të nenit 77 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenet 6, 9, 11 të Vendimit nr. 232 datë 20.12.2019 të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike për të konkluduar se fatura objekt kundërshtimi për vlerën e dëmit ekonomik nuk përbën titull ekzekutiv.⁵³

Në vendimet penale gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (*nenet 76 e 22, 279/2, 236/1, 283, 291, 277, 186, 102 e 22 të Kodit Penal*) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkohet dërgimi në gjyq apo gjykimi i të pandehurit dhe të

⁵¹Vendim nr. 52-2020-168 (52), datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁵²Vendimin nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁵³Vendim nr. 52-2022-123, datë 28.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

përcaktimit të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.⁵⁴

Më konkretisht, gjyqtarja:

- Citon dhe analizon në të katër elementët e tij (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive) figurën e veprës penale të “*Vrasjes me dashje*” e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal. Në këtë kuptim arsyetohet se objekti i kësaj figure të veprës penale është mbrojtja e posaçme e marrëdhënieve juridike që garantojnë jetën e personi. Përsa lidhet me anën objektive, gjyqtarja analizon se vepra kryhet me çdo lloj mënyre apo mjeti (duke përfshirë nën nenin 79 pika “e” e Kodit Penal); se ngjarja ndodh aty për aty, pa shkaqe të mëparshme, në zënie apo grindje. Këtë qëndrim, gjyqtarja e mbështet në praktikën e Gjykatës së Lartë (*Vendim nr. 00-2017-19(17) datë 08.02.2017*). Po në aspektin e anës objektive, gjyqtarja analizon konceptin e “dashjes” si element thelbësor të nenit 76 të K.Penal, duke thirrur për interpretim nën 15 të Kodit Penal, i cili përkufizon “dashjen” si formë faji dhe llojet e tij dashje direkte ose indirekte të cilën e lidh me qëndrimin psikik që mban autori i veprës ndaj veprimeve të kryera dhe pasojës së ardhur është një proces i brendshëm të menduarit që zhvillohet në trurin e njeriut. Këtë qëndrim, gjyqtarja e mbështet në praktikën e Gjykatës së Lartë (*Vendim nr. 00-2015-2454(147) datë 23.09.2015*).⁵⁵
- Interpreton nenin 279/2 të K.Penal si një figurë e veprës penale duke e analizuar në të katër elementët e tij. Në këtë spektër, kur analizon anën objektive, i kushton një vëmendje konceptit të “*mjedisit publik*” të cilin e barazon me konceptet e “*vend publik*” dhe “*mjedise të hapura për publikun*”. Gjyqtarja analizon se çdo mjedis tjetër që kërkon leje, autorizim apo miratim paraprak apo të mëvonshëm, ku personi nuk mund të shkojë lirisht dhe nuk mund të përfitojë nga mundësitë që ai ofron ai mjedis, nuk mund të konsiderohet si “*mjedis publik*”, por si “*mjedis privat*”. Gjyqtarja interpreton qëllimin e nenit 279/2 të K.Penal, duke konkluduar se ligjvënësi në kriminalizimin e këtij fakti (mbajtja e armëve të ftohta në mjedise publike) rrit probabilitetin si të përdorimit të tyre, ashtu edhe të ardhjes së pasojave të rënda.⁵⁶
- Interpreton nenin 236/2 të K.Penal si një figurë e veprës penale duke e analizuar në të katër elementët e tij. Në këtë spektër, kur analizon anën objektive, sqaron mënyrat sesi kryhet kjo figurë e veprës penale vetëm me anë të veprimeve dhe përcakton kushtet që duhet të plotësohen: veprimet të drejtohen ndaj një punonjësi të policisë së rendit publik; të kryhen gjatë kryerjes së detyrës së tij; të bëhen me qëllim pengimin e punonjësit të policisë së rendit publik për të kryer detyrën sipas ligjit.⁵⁷
- Citon dhe interpreton nenin 283/2 të Kodit Penal, duke trajtuar figurën e veprës penale të “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” në të katër elementët e tij : objekti, i cili lidhet me marrëdhëniet juridike që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen, transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope duke

⁵⁴Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes

⁵⁵Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁵⁶Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁵⁷Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

theksuar përjashtimin nga përgjegjësia penale të përdoruesve mbajtës në doza të vogla; ana objektive, e cila kryhet në këto forma: *shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, transportimi, dërgimi, dorëzimi, mbajtja, shpërndarja, tregtimi*. Për secilën nga format, jepet një përkufizim i plotë dhe i qartë.⁵⁸

- Trajton konceptin e përgjegjësive penale dhe elementëve që duhet të plotësohen, duke cituar dhe analizuar në të katër elementët e tij (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive) figurën e veprës penale të *“Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”* parashikuar në nenin 291 të Kodit Penal. Interpretimi bëhet nga pikëpamja teorike e kësaj figure të veprës penale, por dhe në harmoni me rrethanat e rastit në shqyrtim nga gjyqtarja. Duke qenë se neni 291 i K.Penal është një dispozitë blankete, gjyqtarja citon nenet 53-54, 115 të Kodit Rrugor dhe VKM nr. 153 datë 07.04.2000 *“Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”*. Për të konkluduar mbi fajësinë e të pandehurit në rastin konkret, bën një analizë teorike të institutit të barrës së provës së fajësisë që e ka prokurori, sipas të cilit nuk mjafton thjesht përmendja e faktit objekt akuzë apo përmendja e pasojës së ardhur, por kërkohet dhënia e elementëve të tilla provuese, në mënyrë që gjykata të krijojë bindjen e saj në lidhje me bazueshmërinë e akuzës, lidhur me rrjedhën e fakteve dhe lidhjen e veprimeve me pasojën dhe zbërthimin e elementëve penale të veprës në raport me faktet e shqyrtuara.⁵⁹
- Citon dhe interpreton nenin 277 të Kodit Penal, duke trajtuar figurën e veprës penale të *“Vetëgjyqësisë”* në të katër elementët e tij (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive). Në këtë aspekt, në lidhje me objektin e veprës penale argumentohet se dispozita synon të mbrojë jo vetëm ushtrimin e autoritetit shtetëror, por edhe që të parandalojë e ndëshkojë sjelljet dhe veprimet shoqërisht të rrezikshme me të cilat autori i atribuon vetvetes të drejtën për të realizuar një të drejtë apo për të zgjidhur një mosmarrëveshje me viktimën, për të shmangur rrugën e parashikuar nga ligji. Në lidhje me anën objektive, arsyetohet se nga pikëpamja e anës objektive, vetëgjyqësia kryhet nga autori nëpërmjet ushtrimit arbitrar të së drejtës, me forma të ndryshme të dhunës fizike e psikike (kanosjes, etj.) drejtpërdrejtë mbi personin ose indirekt duke vepruar mbi sendin a interesin mbi të cilin ekziston apo pretendohet se ekziston e drejta. Po ashtu, analizohet ana subjektive si një vepër e kryer me dashje të drejtpërdrejtë dhe subjekti është i përgjithshëm. Gjyqtarja citon edhe rastin kur nuk jemi përpara vetëgjyqësisë, atëherë kur autori mbron posedimin e tij të ligjshëm, duke referuar Vendimin unifikues nr. 1 datë 25.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.⁶⁰
- Citon dhe analizon në të katër elementët e tij (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive) figurën e veprës penale të *“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura” e mbetur në tentativë*, parashikuar në nenet 102/1 e 22 të Kodit Penal. Interpretimi bëhet nga pikëpamja teorike e kësaj figure të veprës penale, por dhe në harmoni me rrethanat e rastit në shqyrtim nga gjyqtarja. Në këtë kuptim, lidhur me objektin e figurës së veprës penale argumentohet se mbron marrëdhëniet e vendosura me ligj për të mbrojtur lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të personit, nga veprimet e kryera në kundërshtim me ligjin për të mbrojtur jetën dhe shëndetin, ndërsa lidhur me anën objektive arsyetohet se vepra karakterizohet nga elementi *“dhunë”*, e cila mund të jetë dhunë psikologjike nëpërmjet kanosjes apo dhunës fizike, me duar, duke e goditur, shtyrë apo me përdorimin e mjeteve të tjera me qëllimin e vetëm për të kryer marrëdhënie seksuale me të rritura mbi moshën

⁵⁸Vendim nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁵⁹Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁶⁰Vendim nr. 52-2020-255, datë 12.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

18 vjeç ose ndërmjet bashkëshortëve apo bashkëjetuesve kundër vullnetit të tyre. Përsa i përket anës subjektive analizohet se vepra konsumohet me dashje të drejtpërdrejtë, me vullnet e ndërgjegje përmes dhunës, ndërsa subjekti është i përgjithshëm.⁶¹

- Citon dhe interpreton nenin 186 të K.Penal, ku parashikohet vepra penale e “*Falsifikimit të dokumenteve*” në të katër elementët e kësaj figure të veprës penale (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive). Në lidhje me objektin e veprës penale analizohet se mbron marrëdhëniet e vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt të administratës publike, të organizatave, të partive politike, të ndërmarrjeve, firmave, shoqatave dhe se objekti i krimit mund të jenë dokumente zyrtarë apo privat të ndryshëm. Në lidhje me anën objektive, gjyqtarja i kushton një trajtesë të thelluar anës objektive ku jep kuptimin e dokumentit të falsifikuar (*paraqitja në dokument e rrethanave të rreme ose përpilimi i një dokumenti të falsifikuar si dhe përdorimi i tyre duke i vendosur në qarkullim juridik*); përcakton format që konsumohet kjo vepër penale: falsifikimi (duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi dokumentin, apo me çdo veprim material në një dokument ekzistues falsifikim material/intelektual) ose përdorimi. Këto analiza kryhen mbi bazën e qëndrimit të Gjykatës së Lartë, konkretisht Vendim nr. 24, datë 09.02.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarja trajton dhe analizon gjithashtu edhe kur vepra penale kryhet në bashkëpunim, sjell pasoja të rënda, më shumë sesa një herë, dhe kur ai që e ka bërë është personi që ka për detyrë ta lëshojë.

Përgjithësisht, dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen duke zbërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale, por duke u përqendruar me tepër në anën objektive dhe subjektive të saj. Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë *blankete*, gjyqtarja zbaton dhe në disa raste interpreton edhe dispozita të ligjeve të posaçme ku të referon fakti penal.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtarja interpreton *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- Gjyqtarja trajton diskrecionin e gjykatës në lidhje me individualizimin e dënimit, duke cituar nenet 47, 48/ç, 49, 50 të K.Penal, të cilët interpretohen në lidhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrezikshmërinë e autorit, formën e fajit, rrethanat lehtësuese, mungesa e rrethanave rënduese. Në individualizimin e dënimit, gjyqtarja mban parasysh parimin e proporcionalitetit mes veprës penale të konsumuar dhe dënimit që i caktohet ndaj autorit të saj, si dhe referon në jurisprudencën kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, konkretisht 00-2016-970 (20) datë 01.06.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 47 datë 26.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese.⁶²
- Trajton institutin e parashkrimit të ndjekjes penale si pamundësi e shtetit (organeve të ndjekjes penale) për të kryer hetime dhe për të vendosur përpara përgjegjësisë

⁶¹Vendim nr. 52-2022-90, datë 17.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁶²Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-90, datë 17.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

penale çdo person, nëse vërtetohet fakti juridik me karakter shues, kalimi i afatit kohor nga momenti i kryerjes së veprës penale deri në momentin e marrjes si të pandehur.⁶³

- Citon nenin 59 të Kodit Penal, në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, e interpreton këtë institut në frymën e vendimmarrjes së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 151, datë 18.06.2014, e zbaton në rrethanat e rastit konkret.⁶⁴

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake; në çështjet në të cilat është vendosur pushimi i gjykimit, etj. Konkretisht:

- Në vendimin penal, me objekt miratim marrëveshje për pranim fajësie dhe caktim dënimi, duke interpretuar nenin 406/d të K.Pr.Penale në lidhje me kriteret formale që duhet të plotësojë marrëveshja e fajësisë, Gjyqtarja analizon se duhet: të arrihet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor; prania e detyrueshme e mbrojtësit të të pandehurit gjatë bisedimeve për arritjen e marrëveshjes; vepra penale duhet të dënohet në maksimum jo më shumë se 7 (shtatë) vjet, përveç rastit të bashkëpunëtorit të drejtësisë; të bëhet me shkrim; të përmbajë faktin penal dhe cilësimin juridik, pohimin e të pandehurit, llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues dhe mënyrën e ekzekutimit të rënë dakord, disponimi mbi provat si dhe konfiskimi në rastin e mjeteve dhe produkteve të veprës penale, pëlqimin me shkrim të paditësit civil; shumën e shpenzimeve; nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit. Po ashtu, përmend në vendim se ka zbatuar pikën 4 të nenit 406/dh të K.Pr.Penale duke pyetur personalisht të pandehurin nëse e kuptonte marrëveshjen, përmbajtjen dhe se e ka bërë atë me vullnetin e tij.⁶⁵
- Në vendimet penale⁶⁶ me objekt gjykimin në themel të akuzave të paraqitura, përshkruhet procedura e ndjekur, duke cituar vendimmarrjet e Gjyqtarit të Seancës paraprake që ka vendosur plotësimin e hetimeve për të hetuar në drejtim të përgjegjshmërisë penale të të pandehurit konform nenit 332/ç të K.Pr.Penale; ka dërguar çështjen për gjykim, së bashku me kërkesën për gjykim të shkurtuar, faktin se i pandehuri i ka qëndruar kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe citon nenet 332/dh pika 1, shkronja "c", 403/2, 128/a, 405/6 të K.Pr.Civile si dhe Vendimin Unifikues 2/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilin e interpreton në lidhje me faktet procedurale dhe konkludon në pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar nga gjykata.
- Në vendimet penale me objekt gjykimin e çështjeve në seancë paraprake (*dërgim në gjyq*),⁶⁷ gjyqtarja përshkruan ecurinë procedurale në seancë paraprake mbi caktimin e seancës dhe njoftimin e prokurorit duke cituar pikën 1 të nenit 332 të

⁶³Vendim nr. 52-2021-61, datë 02.03.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁶⁴Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁶⁵Vendim nr. 52-2021-77 (4), datë 17.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁶⁶Vendimet nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022; nr. 52-2022-90, datë 17.05.2022, nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁶⁷Vendimet nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021; nr. 52-2020-255, datë 12.10.2020; të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

K.Pr.Penale; njoftimin e të miturit përmes dorëzimit të aktit të njoftimit prindit duke referuar nenin 140/4 të K.Pr.Penale; citon nenin 332/a/3 të K.Pr.Penale, mbi mundësinë që i ka dhënë palëve për tu njohur me aktet; referon nenin 18 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur mbi njoftimin dhe prezencën e psikologut si mbështetje psikologjike në seancë për të miturin në konflikt me ligjin. Gjyqtarja citon nenin 331 të K.Pr.Penale lidhur me elementët formal që duhet të përmbajë kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq dhe e përqas atë përmes interpretimit literal. Më tej, Gjyqtarja citon paragrafët 2, 3, 4 të nenit 327 të K.Pr.Penale dhe nenin 331/2 të tij, dhe në interpretim sistematik të këtyre dispozitave konkludon se në raport me aktet e paraqitura nga prokuroria, parashikimet e kësaj dispozite janë respektuar dhe arrin në sintezë se në raport me akuzën e ngritur dhe kërkesën e paraqitur hetimet e kryera janë plota në funksion të grumbullimit të provave për të provuar faktin penal në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin.

- Në vendimet penale me objekt gjykimin e çështjeve në seancë paraprake (*pushim procedimi penal*),⁶⁸ gjyqtarja referon nenet 329/a dhe 329/b të K.Pr.Penale për të mbështetur veprimet e gjykatës lidhur me veprimet paraprake për caktimin e seancës, njoftimin e prokurorit, njoftimin e viktimave dhe personit nën hetim, si dhe vijimin e gjykimit pa praninë e viktimave të cilët kanë pasuri dijeni rregullisht për gjykimin dhe nuk janë paraqitur (paragrafi i dytë neni 329/b i K.Pr.Penale). Gjithashtu, gjyqtarja citon nenet 328, 329/a të K.Pr.Penale, në lidhje me rastet e pushimit të akuzës ose çështjes dhe kërkesës për pushimin e akuzës ose çështjes. Megjithatë, në një prej vendimeve me të mitur në konflikt me ligjin⁶⁹, nuk vihet re që të jetë interpretuar, arsyetuar dhe argumentuar nëse nga ana e organit procedues prokuroria është përpiluar Raporti i Vlerësimit Individual, apo nëse ky mungonte, pse vetë gjykata nuk kishte urdhëruar kryerjen e tij, por kishte pranuar dërgimin e çështjes për gjykim në mungesë të këtij raporti. Raporti i Vlerësimit Individual është një akt i rëndësishëm, për tu shqyrtuar nga organi procedues (gjyqtar i hetimeve paraprake, gjyqtar i seancës paraprake, gjyqtar i themelit, prokurori) përpara se të merret një vendim lidhur me të miturin në konflikt me ligjin, konform neneve 22 e 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.⁷⁰ Mungesa e këtij akti, bën që vendimi përkatës për të miturin në konflikt me ligjin të mos përmbajë një

⁶⁸Vendimet nr. 52-2021-61, datë 02.03.2021; nr. 52-2022-159, datë 19.09.2022; nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁶⁹Vendimi nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁷⁰Neni 22 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon se: "1. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, organi që administron procesin e trajton të miturin me kujdes dhe vëmendje të veçantë. 2. Në çdo vendimmarrje në lidhje me të miturin, merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: moshë, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual. 3. Gjykata/prokurori, përpara marrjes së ndonjë vendimi mbi të miturin, thërret, sipas rastit, një ekspert ose grup ekspertësh të disiplinave të ndryshme për vlerësimin e rrethanave individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit në mënyrë që të kuptojë personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij...". Neni 47 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur ndër të tjera parashikon se "1. Prokurori/gjykata në procesin e vlerësimit të të miturit mbështetet në nivelin e zhvillimit, mënyrën e jetesës, edukimin dhe kushtet e zhvillimit, arsimimin, gjendjen shëndetësore, mjedisin familjar dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta...".

arsyetim dhe argumentim miqësor dhe të ndryshëm nga ai që bëhet për të pandehur në moshë të rritur.

- Në vendimet me objekt *“Zgjidhje martesë”*⁷¹ gjyqtarja citon dhe interpreton nenin 134 të Kodit të Familjes sa i përket seancës së pajtimit, duke sqaruar qëllimin e këtij momenti procedural në paditë me objekt zgjidhje martesë, i cili lidhet me dhënien e një mundësie palëve për të rimenduar mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre dhe shmangien e zgjidhjes së martesës.
- Citon dhe zbaton nenin 317 të K.Pr.Civile sa i takon dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm për pjesën e detyrimit për ushqim dhe edukimin e fëmijëve.⁷²
- Në çështjen civile në përfundim të së cilës është disponuar për kthimin e padisë me të meta, gjyqtarja interpreton në mënyrë sistematike nenet 2, 154, 154/a dhe 156 të K.Pr.Civile për të konkluduar se kërkesëpadia paraqitet me të meta, pasi provat shoqëruese nuk janë në formën e kërkuar nga ligji, sepse paraqiten në fotokopje (jo origjinale dhe as të njehsuara), ndaj vendos kthimin e akteve duke u vlerësuar se nuk janë paraqitur ndonjëherë.⁷³ Në këtë vendim palës paditëse nuk i është dhënë kohë që t'i plotësojë të metat e konstatuara⁷⁴. Gjyqtarja ka marrë menjëherë vendimin pasi është njohur me padinë e aktet e saj shoqëruese. Në këtë rast, gjyqtarja nuk arsyeton pse nuk ka mbajtur në konsideratë përcaktimin e nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, ku parashihet dhënia kohë dhe mundësi paditësit për të rregulluar të metat e padisë, të cilat në këtë rast duket që kanë qenë të korigjueshme, dhe vetëm pasi të kalonte afati për plotësimin e të metave, të dispononte me kthimin e padisë si me të meta.⁷⁵ Ky rast evidenton një shmangie nga mënyra se si interpretohen e zbatohen dispozitat procedurale, për garantimin e të drejtës për akses si pjesë e parimit të një procesi të rregullt ligjor.
- Duke interpretuar nenin 32 të K.Pr.Civile lidhur me rastet se kur mund të ngrihet padia, theksohet se pika b e kësaj dispozite është e aplikueshme në rastin padisë me objekt *“vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte”*. Në këtë spektër, analizohet koncepti i *“Librezës së punës”* me ekstremitetet e saj si dokument zyrtar bazë për të vërtetuar vjetërsinë në punë dhe që mund të goditet vetëm për falsitet sipas nenit 253 e vijues të K.Pr.Civile dhe se ky dokument plotësohet mbi bazën e të dhënave që përmban regjistri themeltar i punonjësve, akt zyrtar burimor referues për plotësimin e akteve të tjera zyrtare.⁷⁶

⁷¹Vendimet nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020; nr. 52-2020-97, datë 10.03.2020, dhe nr. 52-2022-211, datë 24.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁷²Vendim nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁷³Vendim nr. 52-2020-296, datë 17.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁷⁴Neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: *“Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime...”* .

⁷⁵Neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: *“Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime...”* .

⁷⁶Vendim nr. 52-2020-202, datë 28.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

Në vendimet me natyrë civile, evidentohet se:

- Në vendimin nr. 52-2021-48, datë 22.02.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjqësor Pukë, gjyqtarja referon jurisprudencën kushtetuese dhe atë të Gjykatës së Lartë për të analizuar se: kompetenca lëndore apo funksionale e gjykatës është e drejta e saj për shqyrtimin e një kategorie të caktuar mosmarrëveshjes, sipas lëndës dhe natyrës së tyre (*Vendim nr. 00-2018-1165 datë 04.12.2018 i Gjykatës së Lartë*); është element që garanton procesin e rregullt ligjor dhe i jep vlefshmëri procesit gjyqësor (*Vendim nr. 23/2009, nr. 7/2009 dhe nr. 16/2012 të Gjykatës Kushtetuese*); natyra e saktë e mosmarrëveshjes rezulton jo vetëm nga identifikimi i asaj që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadsisë, por duhet të shqyrtohen faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve (*Vendim nr. 112, datë 08.06.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).
- Në vendimin nr. 52-2020-168 (52), datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjqësor Pukë, gjyqtarja interpreton nenin 32 të K.Pr.Civile për të analizuar konceptin e legjitimitimit aktiv dhe pasiv (*legitimitatio ad causum*), duke sjellë në referim praktikën e Gjykatës së Lartë (*Vendimet nr. 800, datë 06.06.2006 dhe nr. 353 datë 05.07.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Gjithashtu, në këtë vendim, në kuadër të trajtimit të padsisë së njohjes pronar me parashkrim fitues referohen vendime të Gjykatës së Lartë, në total 11 (njëmbëdhjetë) vendime, dy prej të cilëve janë unifikues. (*Vendime unifikues nr. 3 datë 29.03.2012 dhe nr. 1 datë 06.01.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 800 datë 06.06.2006, nr. 353 datë 05.07.2011, nr. 156 datë 11.05.2016, nr. 367 datë 16.09.2015, nr. 24 datë 13.02.2012, nr. 121 datë 13.04.2016, nr. 130 datë 26.10.2017, nr. 440 datë 16.10.2012, nr. 121 datë 13.04.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.*)
- Në vendimin nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjqësor Pukë gjyqtarja, pasqyron në pjesën arsyetuese qëndrime të Gjykatës së Lartë për të theksuar rëndësinë e marrëdhënies prind – fëmijë dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (*Vendimet nr. 00-2014-711 (53), datë 20.02.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 00-2012-1542 (211), datë 26.04.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*); parimin e interesit më të lartë të fëmijës, (*Vendim nr. 00-2014-1764, datë 08.05.2014 i Gjykatës së Lartë*); detyrimin për ushqim (*Vendim nr. 800, datë 06.06.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).
- Në vendimin nr. 52-2020-202, datë 28.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjqësor Pukë, gjyqtarja referon Vendimin nr. 803 datë 20.06.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për të trajtuar regjistrin themeltar si dokumenti kryesor që vërteton periudhën e qenies në marrëdhënie pune kur është i shoqëruar me borderotë përkatëse.
- Në vendimin nr. 52-2022-123, datë 28.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjqësor Pukë, gjyqtarja referon *Vendimin nr. 3 datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*, për të identifikuar shkakun ligjor të padsisë, si dhe pasqyron në vendim aspekte të gjykimit të padsisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e qëndrimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese lidhur me: vërtetimin e së kundërtës të asaj që pasqyrohet në titullin ekzekutiv në gjykimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv (*Vendim nr. 239 datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*); mospërputhjen midis realitetit që

përfaqëson titulli ekzekutiv me realitetin që ekziston efektivisht (*Vendim nr. 00-2018-269 (23) datë 15.03.2018 i Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 00-2021-1768 (251) datë 23.11.2021 i Gjykatës së Lartë*).

Në vendimet me natyrë penale, evidentohet se:

- Në vendimin nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë Gjyqtarja, citon *Vendimin Unifikues 2/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*, lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar; trajton konceptin e përgjegjësisë penale dhe elementëve që duhet të plotësohen, (*Vendimi nr. 6/36 datë 14.04.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si dhe Vendimit nr. 207 datë 09.11.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*); trajton anën objektive të veprës penale të “*Vrasjes me dashje*”, e cila ndodh aty për aty, pa shkaqe të mëparshme, në zënie apo grindje duke u mbështetur në *Vendim nr. 00-2017-19(17) datë 08.02.2017 të Gjykatës së Lartë*; dallimet midis veprave penale të “*Vrasjes me dashje*” dhe “*Plagosjes së rëndë me dashje*” (*Vendim nr. 00-2015-2454 (147) datë 23.09.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 00-2017-575 (107) datë 05.07.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*.); në kuadër të analizës së figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 279/2 të K.Penal, trajton konceptin e “*mjedisit publik*” të cilin e barazon me konceptet e “*vend publik*” dhe “*mjedise të hapura për publikun*” (*Vendim nr. 00-2016-789 (100) datë 11.05.2016 të Gjykatës së Lartë*.); në individualizimin e dënimit (*Vendimet 00-2016-970 (20) datë 01.06.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 47 datë 26.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese*).
- Në vendimin nr. 52-2020-195 (A 19), datë 23.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, gjyqtarja interpreton nenin 260 të K.Pr.Penale lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit personal, duke iu referuar qëndrimeve të Gjykatës së Lartë (*Vendim nr. 9/13 datë 05.10.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 8/25/1 datë 13.07.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 32, datë 08.09.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).
- Në vendimin nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, gjyqtarja trajton parimin e ligjit penal favorizues duke sjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, *Vendim nr. 00-2016-563 (64) datë 06.04.2016*.
- Në vendimin nr. 52-2022-100, datë 31.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, gjyqtarja trajton institutin e ndalimit si një veprim procedural para-sigurues që kufizon për një kohë të shkurtër lirinë personale të subjektit, duke referuar *Vendimin nr. 97 datë 11.05.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*; citon dhe referon *Vendimin Unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*, çështjet *Neumeister kundër Austrisë, Smirnova kundër Rusisë, Letellier kundër Francës* të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut lidhur me trajtesën që i është bërë rrezikut të largimit në rastin e arrestimit në flagrancë, ku gjyqtarja e konsideron se nuk ndryshon me karakteristikat e ndalimit; *Vendimin nr. 32, datë 08.09.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendimin nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të*

Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme që duhet të plotësohen për të caktuar një masë sigurimi personal.

- Në vendimin nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë gjyqtarja, analizon institutin e barrës së provës dhe parimit se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit, duke iu referuar *Vendimit nr. 57 datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese, Vendimit Unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*; arsyeton parimin e proporcionalitetit në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, procesit riedukativ të suksesshëm, funksionin e parandalimit të përgjithshëm, përmes referencës në jurisprudencën kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, konkretisht *Vendimet nr. 3 datë 02.11.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr. 19 datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese; Vendim nr. 00-2016-970 (120) datë 01.06.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*; trajton institutin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, në frymën e vendimmarrjes së *Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 151, datë 18.06.2014*.
- Në vendimin nr. 52-2020-255, datë 12.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë gjyqtarja, citon rastin kur nuk jemi përpara vetëgjyqësisë, atëherë kur autori mbron posedimin e tij të ligjshëm, duke referuar *Vendimin unifikues nr. 1 datë 25.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*.
- Në vendimin nr. 52-2022-90, datë 17.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, gjyqtarja arsyeton lidhur me krijimin e bindjes së brendshme bazuar në prova, duke iu referuar *Vendimit nr. 207 datë 09.11.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*.
- Në vendimin nr. 52-2022-159, datë 19.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, gjyqtarja analizon nenin 186 të K.Penal, ku parashikohet vepra penale e “*Falsifikimit të dokumenteve*“ ku në lidhje me anën objektive, i kushton një trajtesë të thelluar formave që konsumohet kjo vepër penale, mbi bazën e qëndrimit të Gjykatës së Lartë, konkretisht *Vendim nr. 24, datë 09.02.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*; përmend parimin e ligjshmërisë si e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale në ato raste kur në veprimet/mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të veprës penale, duke iu referuar *Vendimit Nr. 6/36 datë 14.04.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e proporcionalitetit*, mes veprës penale të konsumuar dhe dënimit që i caktohet ndaj autorit të saj, në individualizimin e dënimit.⁷⁷

⁷⁷Vendim nr. 52-2022-226 (30), datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

- *Parimin e interesit më të lartë të fëmijës*⁷⁸ në çështjet ku përfshihen interesa të të miturit (në çështjet civile me objekt "Zgjidhje martesë", por jo në nivele të larta sa i përket çështjeve penale me viktimë të mitur apo të mitur në konflikt me ligjin).
- *Parimin e zbatimit të ligjit penal në fuqi* në kohën e kryerjes së veprës penale dhe parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal më të butë *apo favorizues* për zgjidhjen e çështjes.⁷⁹
- *Parimin e disponibilitetit të padisë*, të cilin e emërton si "*Parimi i iniciativës së palëve*" lidhur me të drejtën e palëve për të kërkuar fillimin e një procesi gjyqësor dhe për të dosponuar lidhur me padinë/ kërkesën në mënyrë individuale.⁸⁰
- *Parimin se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit*, duke u theksuar se i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor.⁸¹
- *Parimin e krijimit të bindjes së gjykatës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri.⁸²
- *Parimin e ligjshmërisë* si e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale;⁸³
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës)* si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke iu referuar aspektit procedural të gjykimit që lidhet me të drejtën e mbrojtjes, me përjashtim të së drejtës për akses në gjykatë në çështje civile ku disponon me kthimin e padisë me të meta pa i dhënë mundësi paditësit që t'i plotësojë ato.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtarja parashtrori kundërshtimet e saj, duke u shprehur se: "*Në nenin 154/a, paragrafi 2 të K.Pr.Civile, parashikohet se "Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes se saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime". Sa me sipër, ashtu si dhe e kam argumentuar në vendimin e cituar në raport, ligji i jep gjyqtarit të vetëm të drejtën që në vlerësim të rastit, të disponojë në dy mënyra, të cilat dhe nga mënyra se si është shkruar norma, janë alternative të njëra-tjetrës, "të ktheje padinë", ose "të njoftoje me shkrim për plotësimin e të metave", pa e kushtëzuar këtë vendimmarrje me llojin e të metave. Mendoj se qëndrimi i mbajtur në raport se, gjyqtari në çdo rast që të metat janë të korigjueshme, duhet të disponojë me lënien kohe për plotësimin e të metave, për shkak se kjo nuk garanton të drejtën e aksesit në gjykate, në kuadrin e parimit të një procesi të rregullt ligjor, nuk gjen mbështetje ligjore. E drejta e gjyqtarit për të disponua sipas nenit 154/a të K.Pr.Civile dhe ndikimi i kësaj vendimmarrje në parimin e mësipërm, është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, e cila me vendimin Vendim nr. 7 date 14.01.2022, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën: "Shfuqizimi i togfjalëshit "ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose" në paragrafin e tretë të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi bie në kundërshtim me nenet 4, 17 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. ", ka arritur ne*

⁷⁸Vendim nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁷⁹Vendim nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁸⁰Vendim nr. 52-2020-296, datë 17.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁸¹Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁸²Vendim nr. 52-2022-90, datë 17.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁸³Vendim nr. 52-2022-159, datë 19.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

konkluzionin se: Sipas nenit 154/a, paragrafi i trete, te KPC-së, në rastet kur kërkesëpadia nuk i plotëson kushtet e kërkuara nga kreu I i titullit I të pjesës së dytë të KPC-së, gjyqtari i shkallës së parë ka dy mundësi: t'ia ktheje paditësit kërkesëpadinë në kohën e paraqitjes së saj ose ta njoftoje me shkrim për plotësimin e të metave, duke i caktuar një afat për këtë. Disponimi i gjyqtarit në lidhje me këto dy mundësi është në diskrecion të tij, në varësi të vlerësimit që ai bën në drejtim të plotësimit të kushteve të kërkuara në mënyrë rigoroze nga ligji procedural për kërkesëpadinë e paraqitur. Pjesë e këtij vlerësimi nuk përjashtohet të jetë edhe lloji i te metave, pra nëse ato janë të ndreqshme ose janë të tilla që nga ana substanciale mund të konsiderohen si të pandreqshme/të pakapërcyeshme. Kolegji vlerëson se dispozita e kundërshtuar nuk e pengon aksesin e individit në gjykatë. Ajo, si normë procedurale, zbatohet në rastet e mosrespektimit nga ana e paditësit të kushteve ligjore të formës dhe përmbajtjes së kërkesëpadiës, duke garantuar të drejtën e aksesit në gjykatë në përputhje me kriteret ligjore. Detyrimi për të plotësuar të gjitha elementet e formës dhe përmbajtjes së kërkesëpadiës, të përcaktuara në nenin 154 te KPC-së, i takon individit në mënyrë që ai të ketë akses në gjykim dhe t'i hape rrugën procesit gjyqësor të themelit.⁸⁴ Në përfundim, Gjykata Kushtetuese shpreh se, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë gëzon diskrecion të plotë për sa i përket disponimit të tij, sipas nenit 154/a të KPC-së, në rastet kur kërkesëpadia nuk i plotëson kushtet e kërkuara nga ligji procedural. Ky lloj diskrecioni i jep edhe me shume pavarësi gjyqtarit për të vlerësuar nëse është rasti për kthimin e akteve në kohën e paraqitjes së padisë ose për kthimin e kërkesëpadiës për plotësim. Sa me sipër, duke iu kthyer rastit objekt vlerësimi, mendoj se, vendimmarrja ime për kthimin e padisë dhe akteve të tjera paditësit, është në përputhje me parashikimet e K.Pr.Civile dhe nuk e cenon të drejtën e aksesit në Gjykatë. Kjo duke patur parasysh që, në rastin konkret paditësi, kishte depozituar në gjykatë vetëm padinë, të pashoqëruar me asnjë akt provues, duke mos plotësuar kushtet formale paraprake për marrjen në shqyrtim të një padie, nuk rezultonte që nga kthimi i akteve paditëseve t'i cenohej ndonjë e drejte, pasi nuk i kalonte afati për riparaqitjen e padisë, dhe njëkohësisht, në çdo vendim për kthimin e akteve paditësit i bëhet me dije, e drejta që ka, që me marrjen e vendimit formë të prerë, të tërheqë aktet pranë sekretarisë gjyqësore me qellim riparaqitjen e kërkesëpadiës në përputhje me vendimin e gjykatës, duke shmangur ripagimin e detyrimeve financiare. Sa me sipër, duke parë në tërësi të dhënat e përmendura në raport, lidhur me aftësinë për të interpretuar ligjin, dhe rezultat e arritura, të cilat shprehin se, është treguar kujdes i veçantë për interpretimin e normave materiale dhe procedurale, referuar rrethanave të rastit konkret, në çdo vendim argumentohet ecuria procedurale, mbështetur në normat konkrete, interpretohen parimet e së drejtës, ligjet referuese, vendimi mbështetet në jurisprudencë relevante, mendoj se konkluzioni i arritur në raport se "nuk interpretohen me të njëjtën mase kujdesi dispozitat e gjyqtarit të seancës paraprake, në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin si dhe të gjyqtarit të vetëm, në momentin e paraqitjes së padisë e veprimeve paraprake në çështjet civile, dhe se pavarësisht se behet fjalë vetëm për 2 çështje, ato janë tregues i gjyqtarës për të interpretuar ligjin procedural në të gjitha çështjet e të njëjtit lloj", nuk është i drejte, për shkak se vendimmarrje në çështjen civile është e bazuar në parashikimet ligjore dhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese,

⁸⁴Vendimi nr. 7 date 14.01.2022 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

ndërkohë që, lidhur me çështjen penale me të mitur në konflikt me ligjin, duhet të mbahet parasysh praktika e kësaj kategorie çështjesh në gjykatën ku unë ushtroja detyrën. Nuk qëndron fakti, se vetëm një vendim me të mitur në konflikt me ligjin, tregon aftësinë e gjyqtarit në këtë kategori çështjes, kjo në kushtet kur praktika për këtë lloj çështjes në gjykatën ku unë ushtroja detyrën, ishte minimale. Për rrjedhojë, vlerësoj se vetëm një çështje nuk duhet të ndikojë në vlerësimin total që unë si gjyqtare kam për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes...”

Pasi dëgjoi relatorin e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtares, Këshilli vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga ana e relatorja. Vlerësuesi nuk ndërhyr në bindjen e brendshme të gjyqtarit dhe as në mënyrën se si ai e zgjidh çështjen. Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të analizuar dhe interpretuar dispozitat si dhe arsyetimi i gjyqtarit për mënyrën e zbatimit të tyre mbi faktet objekt gjykimi. Në vendimin e “kthimit të padisë” pa i njoftuar paditësit të metat e konstatuara, gjyqtarja nuk analizon pse ka arritur në këtë vendimmarrje, edhe pse të metat kanë qenë të korigjueshme. Ushtrimi i diskrecionit në këtë rast, për të cilin gjyqtarja i referohet vendimit nr.7 dt. 14.01.2022 të Gjykatës Kushtetuese, nuk është i shoqëruar me dhënien e një argumentimi të bazuar. Gjyqtari duhet të bazojë analizën dhe argumentimin e tij edhe në rast kur vendos të kthejë menjëherë aktet, pa njoftuar të metën e padisë. Në vendimin nr.7 dt.14.01.2022 Gjykata Kushtetuese (Kolegji prej 3/anëtarë) ka disponuar për moskalimin e çështjes në seancë penale. Edhe pse ky vendim nuk përbën jurisprudencë detyruese, madje edhe për vetë Gjykatën Kushtetuese, e rëndësishme është mënyra se si lexohet edhe zbatohet ky vendim i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, sepse mënyra e të kuptuarit, të zbatuarit të dispozitave dhe harmonizimi i tyre, nuk është çështje e juridiksionit kushtetues. Pavarësisht se në këtë vendim përmendet se gjyqtari i shkallës së parë gëzon diskrecion të plotë për sa i përket disponimit të tij, sipas nenit 154/a të K.Pr.Civile, në rastet kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e kërkuara nga ligji procedural, interpretimi dhe zbatimi i dispozitave duhet të shoqërohet me dhënien e një argumentimi bindës nga ana e gjyqtarit, i cili edhe kur të metat janë të korigjueshme, në ushtrim të këtij diskrecioni, vendos të kthejë menjëherë aktet, pa i dhënë mundësi palës të njihet me të metat e t'i rregullojë ato. Gjyqtari në çdo rast duhet të vlerësojë sikundër përmend edhe vendimi i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese nëse lloji i të metave është i tillë që mund të ndreqen dhe kjo gjë duhet të dalë qartazi në vendimin e tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka aftësi të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, por jo në të njëjtën masë kujdesi kur interpretohen e zbatohen dispozita që lidhen me detyrat e gjyqtarit të hetimit paraprak në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin si dhe të gjyqtarit të vetëm në momentin e paraqitjes së padisë e veprimeve paraprake në çështjet civile. Pavarësisht se bëhet fjalë vetëm për 2 çështje gjyqësore, ato janë tregues i aftësisë së gjyqtares për të interpretuar ligjin procedural në të gjitha çështjet e të njëjtit lloj. Ndërkohë dispozitat e ligjit material

rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, shoqëruar nga identifikimi i praktikës gjyqësore relevante.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa, thonjëza ose nga konteksti i fjalisë, paragrafit), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁸⁵ Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit,⁸⁶ përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptimi del qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (me objekt zgjidhje martese), evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të pretendimeve nga palët, në respektim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.⁸⁷ Po ashtu, në vendimet gjyqësore penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe viktimë të mitur, vihet re se gjyqtarja i kushton vëmendje terminologjisë miqësore me të miturin, duke bërë kujdes në përdorimin e termave të duhur, të tillë si “i mitur në konflikt me ligjin” dhe jo i pandehur.⁸⁸

⁸⁵P.sh: “*ipso lege*”, “*legitimatia ad causum*”, *in dubio pro reo*, etj.

⁸⁶Vendim nr. 52-2020-150 datë 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2021-18, datë 25.01.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-90 datë 17.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-226, datë 08.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁸⁷Vendim nr. 52-2020-150 datë 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁸⁸Vendim nr. 52-2021-34, datë 03.02.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, dhe paragrafët në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së gjuhës së përdorur. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Gjyqtarja jo gjithmonë ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, së cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe atyre thelbësore, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Në vendimet gjyqësore të analizuara jo gjithmonë ka një metodologji të qartë në strukturimin e pjesëve përbërëse të vendimit.

Edhe pse struktura e vendimeve gjyqësore vizualisht është e ndarë në pjesë me tituj, në aspektin përmbajtësor jo gjithmonë gjendet e pasqyruar ajo çka lexuesi ka pritshmëri të gjejë kur lexon titullin. Gjyqtarja jo gjithmonë bën një ndarje të qartë midis ecurisë procedurale apo rrethanave procedurale nga rrethanat e faktit. Në një rast pikërisht për shkak të mosbërjes së kësaj ndarjeje, nuk kuptohet cilësia me të cilën gjykata ka dispozuar për zëvendësimin e masës së sigurimit (gjyqtar hetimi paraprak apo gjyqtar seance paraprake), ndaj një personi që referuar arsyetimit të vendimit rezulton të ketë marrë cilësinë si i pandehur, ndërkohë që në pjesën hyrëse pasqyrohet si palë e

interesuar.⁸⁹ Pavarësisht se përdorimi i termit “palë e interesuar” në pjesën hyrëse të vendimit mund të jetë edhe një gabim material, në kushtet kur subjektet procedurale në pjesën arsyetuese emërtohen drejt, mosstrukturimi i pjesës përshkuese-arsyetuese, duke ndarë elementët procedurale nga rrethanat e faktit, zbeh kuptueshmërinë në tërësi të gjithë gjendjes së procedimit mbi të cilën është kërkuar dhe zëvendësuar masa e sigurimit.

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prania ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të listuar formalisht me tituj që përgjithësisht ndjekin këtë renditje:

- (i) *procedura*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes, si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar apo veprimet paraprake, veprimet përgatitore, ecuria procedurale në rast të ndryshimit të trupit gjykues. Në disa raste, gjyqtarja ecurinë procedurale e integron në pjesën e emërtuar “Rrethanat e çështjes”.
- (ii) *“Rrethanat e çështjes” ose “Rrethanat e faktit”* ku përmbahen: faktet e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave.
- (iii) *vlerësimi i gjykatës* ku gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin abstrakt të tij, para aplikimit mbi faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai më natyrë procedurale ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Në ndonjë rast, gjyqtarja para arsyetimit ligjor, ka referuar dhe cituar në një nënndarje me vetë dispozitat e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, të cilat më pas integrohen në arsyetim.⁹⁰

⁸⁹Vendimi Nr.52-2020-195, datë. 23.07.2020

⁹⁰Vendim nr. 52-2020-168, datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.; Vendim nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2020-97, datë 10.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Vendim nr. 52-2022-211, datë 24.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

Në dy vendime civile⁹¹ pretendimet e palëve pasqyrohen para rrethanave të faktit, si një sintezë e kërkimeve/prapësimeve thelbësore të tyre, të cilat në aspektin e kuptueshmërisë për lexuesin duhet të qëndronin të pozicionuar në strukturën e vendimit pas paraqitjes së fakteve të çështjes, me një rrjedhje normale të logjikës nga fakti tek ajo çka pretendohet mbi këtë fakt.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim disponimi i gjykatës mbi padinë e ngritur (*pranimin, pranimin pjesërisht apo rrëzimin e kërkesë padisë; përcaktimin se vendimi gjyqësor përbën titull ekzekutiv*), ai në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor por edhe deklarimin e pafajshëm*), mënyra e disponimit për çështjet specifike të seancës paraprake (*për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal*), caktimin e llojit të dënimit, masën e tij duke aplikuar uljen, momentin e fillimit të ekzekutimit të dënimit, disponimi mbi provat materiale dhe masat e sigurimit, aplikimi i alternativave të dënimit duke përcaktuar kohëzgjatjen konkrete, si dhe kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet në dispozitiv e drejta e ankimit, gjykata kompetente, dhe afati i ushtrimit të saj, me përjashtim të njërit vendim në të cilin nuk sqarohet dhe nuk përcaktohet e drejta e ankimit të veçantë për një nga pikat e dispozitivit (*dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm*), e dallueshme nga e drejta e ankimit nga pikat e tjera.⁹² Lidhur me shpenzimet gjyqësore, i përlllogarit ato në vendimet gjyqësore civile, por në rastet e pranimit të pjesshëm të padisë, nuk saktëson masën që duhet t'i ngarkohen palës gjyqëmbësore.⁹³ Në vendimet penale me objekt “*pushim procedimi penal*” dhe “*dërgim në gjyq*” nuk llogarit shpenzimet gjyqësore, pavarësisht se disponon “*lihen siç janë bërë*”. Po ashtu, edhe në vendimet penale të themelit, në rast të deklarimit fajtor përlllogariten vetëm shpenzimet gjatë hetimeve paraprake, ndërsa nuk përcaktohet masa e shpenzimeve gjyqësore (*njoftime, mbrojtës kryesisht*) që i ngarkohen të pandehurit, pavarësisht se disponohet se ato i ngarkohen të pandehurit.

Vendimet gjyqësore përmbajnë përgjithësisht të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale të themelit.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtarja parashitroi kundërshtimet e saj, duke u shprehur se: “*Lidhur me këtë aspekt, vlerësoj të theksoj se, jo çdo vendim gjyqësor mund të ketë të njëjtën strukturë, për shkak se dhe ecuria dhe veprimet e gjyqtarit nuk janë të njëjta në çdo çështje. Kështu, nuk mund të ketë strukturë të njëjtë një vendim në të cilin është disponuar me kthimin e akteve dhe një padi themeli; një kërkesë për vërtetim fakti, në të*

⁹¹Vendimi nr. 42, datë 28.06.2022 dhe vendimi nr. 52, datë 22.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁹²Vendim nr. 52-2020-150, datë 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁹³Po aty

cilin ligji i zbatueshëm është vetëm neni 388 i K.Pr.Civile, me një padi pronësie themeli, në të cilin mund të kemi kërkesa për shtim apo pakësim objekti, shtim ndërgjyqësisë. Për këtë shkak, jo në çdo vendim gjyqësor mund të strukturohet si pjesë e vendimit "Procedura apo Ligji i zbatueshëm", e për rrjedhojë ato integrohen në pjesët e tjera të vendimit. Në raport është marrë në analizë një vendim penal, lidhur me "zëvendësim mase sigurimi". Duke mos qenë dakord lidhur me konkluzionin e arritur se në këtë vendim, nuk kuptohet gjendja e procedimit, argumentoj se: cilësimi i personit ndaj të cilit kërkohet zëvendësimi i masës së sigurimit si "person i interesuar", në pjesën hyrëse të vendimit, është bere për të ndarë pozitën e tij në këtë proces gjyqësor, që ishte zëvendësimi i masës së sigurimit, nga kërkuesi që ishte Prokuroria. Fakt i cili nuk mendoj se konfondon kuptimin e rrethanave të çështjes, në kushtet kur, në përmbajtje të vendimit, në kundërshtim me çfarë thuhet në raport, është përshkruar në mënyrë koherente vijimësia e çështjes, duke filluar nga regjistrimi i kallëzimit penal, ndalimi i personit, caktimi i masës së sigurimit, disponimi i Gjykatës së Apelit, paraqitja e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe disponimi i gjykatës lidhur me këtë fakt. Sa me sipër, mendoj se, del qartë që, gjykata e cila po e merrte në shqyrtim kërkesën se gjyqtari kompetent i seancës paraprahe, sa kohë në vendim nuk citohet më tej se çështja kishte kaluar për gjykim në themel, pranë një gjyqtari tjetër. Lidhur me faktin se, është konsideruar mangësi, mos përcaktimi i shpenzimeve gjyqësore, në çështjet penale, theksoj se kjo llogaritje përpara përfundimit të procesit gjyqësor është e pamundur, për shkak se deri në dhënien e vendimit nga gjykata nuk ka shpenzime të llogaritura. Kështu, shpërblimi për avokatet e caktuar kryesisht nga gjykata, bëhet sipas një formulari të posaçëm dhe miratohet nga kryetari i gjykatës, për rrjedhojë nuk mundet gjyqtari të përllogarisë paraprakisht këtë fakt. Shpenzimet gjyqësore në çështjet penale, përllogariten nga kryesekretaria dhe ekzekutohen sëbashku me disponimet për provat materiale. Sa me sipër, duke mbajtur qëndrimin se, është e pamundur që në të gjitha vendimet të mbahet e njëjta strukturë vendimi, por pavarësisht kësaj, në çdo vendim gjyqësor, i kushtoj një rendësi të veçantë, ecurisë procedurale të çështjes, duke sqaruar çdo vendimmarrje deri në ato momente, rrethanave të faktit, duke u përpjekur të jenë sa më të qarta dhe të përmbledhura, dhe arsyetimit ligjor. Për rrjedhojë, mendoj se për këtë pikë të raportit, duhet të vlerësohem mbi mesataren”.

Pasi dëgjoi relatorin e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarës, Këshilli vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga ana e relatorja. Këshilli vlerësoi se organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumentave ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, çka i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në

funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi mesatare në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor, por jo gjithmonë përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu dhe në atë përmbajtësor. Mosndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, jo gjithmonë orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “Mesatare”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton përgjithësisht një nivel i mirë arsytimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake; procedimit me gjykim të shkurtuar, etj.

Arsytimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Pasi dispozita zbërthehet dhe interpretohet në kuptimin abstrakt, ajo vijon të aplikohet mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Gjyqtarja tregon kujdes në arsytim dhe mënyrën e organizimit të tij, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj në themel.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtarja kujdeset për të evidentuar në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit/çështjes, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi evidentimit dhe plotësimin me argumente të marrëdhënies shkak-pasojë, në përjashtjen e ligjit me faktet konkrete. Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim. Këtu bën përjashtim : (i) një çështje civile,⁹⁴ në të cilën nga ana e palës paditëse është kërkuar sigurimi i padisë, kërkesë e cila është pranuar nga gjyqtari i caktuar fillimisht me short,⁹⁵ dhe pasi gjyqtarja subjekt vlerësimi ka marrë dosjen në shqyrtim me anë të shortit, për shkak të largimit të përligjur të trupit të mëparshëm gjykues, nuk rezulton të ketë disponuar lidhur me sigurimin e padisë, as gjatë gjykimit dhe as në vendimin përfundimtar⁹⁶. Në këtë çështje civile argumentimi logjik duket si kontradiktor me mënyrën e disponimit përfundimtar, pasi edhe pse gjyqtarja ka analizuar elementët e faturës së konsumit të energjisë elektrike si titull ekzekutiv dhe ka konkluduar se faturimi i “dëmit ekonomik” nuk mund të jetë element i faturës, ka konkluduar për rrëzimin e padisë, duke arsyetuar “...për faturën e dëmit ekonomik është përcaktuar në mënyrë të qartë rruga ligjore, për kundërshtimin e saj, afatet për paraqitjen e ankesës, organi kompetent që e merr në shqyrtim...”.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh:

- (i) *Instituti të zgjidhjes së martesës*, format e zgjidhjes së saj, duke u ndaluar në mënyrë më të detajuar në analizën e rastit konkret, atë me pëlqim reciprok të palëve. Po ashtu ndalet në trajtimin e pasojave ligjore që rrjedhin nga zgjidhja e martesës lidhur me: lënie e fëmijës për rritje dhe edukim; detyrimin për ushqim, si dhe të drejtën e takimit për prindin tjetër, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës;⁹⁷
- (ii) *Mjeteve të posaçme të mbrojtjes gjatë fazës së ekzekutimit*, duke analizuar dispozitën procedurale që parashikon pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, duke u ndalur në verifikimin nëse fatura e energjisë elektrike sipas zërave të saj përbën titull ekzekutiv, referuar legjislacionit të posaçëm rregullator;⁹⁸

⁹⁴Çështja me nr. 34/165, datë regjistrimi 13.12.2021, Nr. vendimi 52-2022-123 (42) datë 28.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, me objekt: “Pavlefshmëri titulli...Marrjen e masës provizore për sigurimin e padisë...”.

⁹⁵Në seancën e datës 20.12.2021 trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtare F.H ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesës të paditësit N.L për sigurimin e padisë. 2. Urdhërimin e palës së paditur për rilidhjen e energjisë elektrike abonentit familjar N.L me nr. Kontrate F085595, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor me vendim të formës së prerë. 3. Ankimi ndaj këtij vendimi gjyqësor nuk e pezullon zbatimin e menjëhershëm të këtij vendimi gjyqësor...”.

⁹⁶Neni 211 i Kodit të Procedurës Civile ndër të tjera parashikon se : “Kur vendoset refuzimi i padisë ose pushimi i gjykimit të saj, gjykata vendos heqjen e sigurimit të padisë, e cila zbatohet kur vendimi të marrë formën e prerë”.

⁹⁷Vendimi nr.52-2020-150, datë 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

⁹⁸Vendimi nr. 52-2022-123, datë 28.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

- (iii) *Padia e njohjes pronar përmes parashkrimit fitues me ose pa titull*, duke trajtuar këtu: legjitimin aktiv dhe pasiv në këtë padi; elementët kryesorë të parashkrimit fitues të cilët janë: posedimi, kohëzgjatja e posedimit dhe mungesa e ushtrimit të tagrave të pronësisë së pronarit; natyra e kësaj padie, dy kushte kumulative për parashkrimin fitues pa titull: posedimi i qetë, pa ndërprerje e sjellje si pronar dhe kalimi i afatit 20 vjeçar; etj.,⁹⁹
- (iv) *Analizën e padisë së njohjes sipas parashkrimeve të nenit 32/c të K.Pr.Civile*, duke u ndalur në mënyrë të posaçme në çështje të interesit të ligjshëm, legjitimitetin e palës paditëse për ngritjen e kësaj padie, dhe duke vijuar me analizën e rrethanave konkrete të kërimit mbi vërtetësinë e të dhënave të pasqyruara në fletën e regjistrimit të marrëdhënieve të punës,¹⁰⁰ etj.

Në vendimet penale burim vlerësimi, karakteristikë e gjyqtarës është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë.

Në çdo rast, interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsytimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimit logjik, kryesisht në drejtim të :

- (i) figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet dhe elementëve e saj, si dhe autorësisë e të pandehurit,¹⁰¹
- (ii) ecurisë procedurale të gjykimit në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar;
- (iii) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të individualizimit të dënimit,¹⁰²
- (iv) aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke analizuar kriteret ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për aplikimin e kësaj alternative.¹⁰³

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtarja parashtroi kundërshtimet e saj, duke u shprehur se: *"Në këtë pjesë të raportit është marrë në analizë një çështje civile me objekt "Pavlefshmëri titulli ekzekutiv fature tatimore energjie elektrike", në të cilën unë kam disponuar me rrëzimin e padisë, duke e cilësuar këtë vendimmarrje si kontradiktore, për faktin se, edhe pse fatura e energjisë elektrike është titull ekzekutiv, është vendosur në fund me rrëzimin e padisë. Për sa me sipër, dua të sqaroj se, në vendimin e sipërcituar mendoj se kam bërë një argumentim gjithëpërfshirës të faktit se çfarë konsiderohet titull ekzekutiv, çfarë kriteresh duhet të plotësojë fatura e energjisë elektrike për t'u konsideruar titull ekzekutiv, dhe kur legjitimohet paditësi të ngrejë një padi sipas nenit 609 të K.Pr.Civile. Kështu, kam interpretuar dhe cituar legjislacionin e posaçëm, i cili rregullon në mënyrë të posaçme lëshimin e faturave dhe mbledhjen e detyrimeve që*

⁹⁹Vendimi nr. 52-2020-168 (52), datë 22.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹⁰⁰Vendimi nr.52-2020-202, datë 28.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹⁰¹Në të gjitha vendimet penale të themelit apo edhe ato të seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, gjyqtarja ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe përjasjen e faktit të provuar në raport me to, në funksion të vlerësimit të saj mbi cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet

¹⁰²Në të gjitha vendimet penale të themelit

¹⁰³Vendim nr. 52-2020-170, datë 10.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

rrjedhin nga konsumi i energjisë elektrike dhe nga ana tjetër parashikon në mënyrë të veçantë përcaktimin e vlerës së dëmit ekonomik, llogaritjen e tij, lëshimin e faturës së dëmit ekonomik, dhe më pas mënyrën e ankimit dhe mbledhjes së detyrimit. Kështu, në nenin 11, të vendimit nr. 232, datë 20.12.2019 "Për miratimin e rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike" përcaktohet: "Çdo përdorues i rrjetit, në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, si dhe legjislacionit në fuqi, ka të drejtën e ankimit në OSSH dhe/ose në ERE, në rast se kundërshton faturën e dëmit ekonomik të vendosur nga OSSH-ja ose pretendon se OSSH-ja nuk ka ndjekur dhe zbatuar dispozitat e kësaj Rrugoreje" ndërkohë që, neni 1 i ligjit nr. 8662, dt. 18.09.2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike ", i ndryshuar, parashikon shprehimisht: "Fatura tatimore e konsumit të shitjes, të blerjes dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas, modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 7928, dt.27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" është titull ekzekutiv dhe ngarkohen Zyrat e Përmbartimit me ekzekutimin e tyre". Sa më sipër, ligji e përcakton qartë që fatura e energjisë elektrike përben titull ekzekutiv, vetëm kur ajo përmban vlerën e konsumit të energjisë elektrike, dhe jo kur ajo është një faturë për llogaritjen e dëmit ekonomik. Nëse pala ka kundërshtime për këtë detyrim, ajo mund të ndjekë rrugën administrative të ankimit, ose t'i drejtohet gjykatës me një padi themeli. Dhe nëse palës i është ndërprerë shërbimi i energjisë elektrike si rrjedhojë e këtij detyrimi, përsëri mund t'i drejtohet gjykatës me një padi themeli për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrate dhe rilidhjen e energjisë elektrike. Për rrjedhojë, nuk mendoj se qëndron përfundimi i arritur në raport se kjo vendimmarrje është kontradiktore, kjo duke patur parasysh se, ky qëndrim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, por për shkak të pamundësisë për të aksesuar sistemin e kisha të pamundur të mbështesja sa më sipër me vendime konkrete. Në raport specifikohet se, citoj: "karakteristike e gjyqtares është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementeve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj. Çdo fakt i vlerësuar i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin." Ndërkohë që, më tej, në raport thuhet se, " ..e njëjta rrjedhë logjike dhe cilësi analitike nuk spikat, kur analizohet zbatimi i dispozitës mbi faktet e provuara, e cila është ajo që lidhet drejtpërdrejtë me konkluzionin e arritur ", përfundim ky i cili me duket kontradiktor me përfundimin e cituar një paragraf më sipër. Nuk është identifikuar dhe referuar në raport asnjë vendim, në të cilin analiza e konkluzionit të ketë qenë e cunguar. Mendoj se, në çdo vendim penal i kushtoj një kujdes të veçantë si analizimit të dispozitave të zbatueshme, rrethanave që rezultojnë të provuara dhe në fund padyshim mënyrës se si dispozita zbatohet në rastin konkret. Vlerësoj se, ekuilibri ndërmjet pjesës së citimit të ligjit të zbatueshëm, rrethanave të faktit që rezultojnë të provuara, dhe zbatimit të tyre në rastin konkret, nuk mund të jetë i njëjtë në çdo vendim gjyqësor. Për shembull, në një vendim në të cilin i pandehuri procedohet për kryerjen e veprës penale "Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në rast drejtimi pa dëshminë e aftësisë, interpretimi i ligjit do të zërë më shumë vend, pasi do analizohen si dispozitat e Kodit Penal, Kodit Rrugor dhe aktet nënligjore, ndërkohë

që zbatimi i dispozitës mbi faktet e provuara, nuk mund të zërë shumë vend, pasi provat që provojnë faktin janë te pakta. Ndërkohë nga ana tjetër, në një vendim për veprën penale të "Vrasjes", së mbetur në tentative, ky raport ndryshon, në favor të analizimit të fakteve të provuara”.

Pasi dëgjoi relatorin e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarës, Këshilli vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga ana e relatorja. Edhe pse analiza e detajuar e provave dhe interpretimi i ligjit është pjesë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi, ajo nuk është e mjaftueshme për të gjykuar mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të gjyqtarit. Nëse ajo nuk shoqërohet me të njëjtën shkallë kujdesi me analizën se si konceptet ligjore dhe institutet lidhen midis tyre apo se si ato zbatohen në një situatë të caktuar (faktet e provuara), argumentimi logjik nuk është shterues. Në dokumentet ligjorë spikat aftësia e gjyqtarës në drejtim të analizës së provave dhe interpretimit të ligjit, madje të dy këta komponentë zënë peshën më të madhe të arsytimit të vendimeve, analizë që bazohet në arsye dhe logjikë. E njëjta rrjedhë logjike dhe cilësi analitike nuk spikat në çdo rast kur analizohet zbatimi i dispozitës mbi faktet e provuara, e cila është ajo që lidhet drejtpërdrejt me konkluzionin e arritur. Në vendimet gjyqësore nuk ka një ekuilibër midis pjesës përshkuese dhe asaj analitike, duke mos i dhënë më shumë rëndësi kësaj të fundit. Gjyqtarja nuk është për të përshkruar, por për të analizuar dhe vlerësuar. Peshën më të madhe në vendim duhet ta zërë pikërisht komponenti analitik, prandaj sasia e arsytimit duhet të mbizotërohet nga pjesa analitike dhe argumentimi logjik se si dispozitat e interpretuara në mënyrë abstrakte dhe praktika gjyqësore zbatohet mbi faktet e provuara.

Nëse argumentimin logjik të analizës do ta ndanim në dy pjesë, në procesin analitik të të provuarit të fakteve dhe atë logjik se si konceptet, institutet dhe dispozitat ligjore zbatohen në një situatë të caktuar të provuar, i pari mbizotëron në analizën e gjyqtarës. Peshën kryesore në vendimet gjyqësore të analizuarra e zë kryesisht procesi analitik i të provuarit të fakteve dhe ai i interpretimit abstrakt të normës materiale. E njëjta shkallë aftësie nuk evidentohet në analizën e zbatimit të ligjit mbi faktet e provuara. Kjo mënyrë e të shkruarit dhe të arsyetuarit, jo gjithmonë evidenton nëse faktet konkrete të çështjes janë të asaj natyre, cilësie (kualiteti) dhe të tilla çfarë kërkohet nga dispozitat e ligjit material apo atij procedural, në lidhje të drejtpërdrejtë me konkluzionin e arritur.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.). Pretendimet e palëve merren gjithmonë në shqyrtim dhe analizohen në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre. Ato integrohen natyrshëm në arsytimin tërësor të vendimit gjyqësor.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
86	Shumë mirë

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi “Mbi mesataren” në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Edhe pse cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, nuk reflektohet e njëjta shkallë kujdesi në lidhje me argumentimin logjik se si dispozitat ligjore zbatohen mbi faktet e provuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Në tërësi, referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Mbi mesatare” duke e pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtares në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 77 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (31 çështje¹⁰⁴ në vitin 2020, 25 çështje¹⁰⁵ në vitin 2021 dhe 21¹⁰⁶ çështje në vitin 2022),

¹⁰⁴Çështjet me afat ligjor të përfunduara brenda afatit ligjor në vitin 2020 janë çështjet me numër rendor 26, 27, 28 në Tabelën nr. 3; çështjet me numër rendor 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, dhe 14 në Tabelën nr. 10; çështjet me numër rendor 9, 32, 38 në Tabelën nr. 11 dhe çështja me numër rendor 5 në Tabelën nr. 12. Çështjet me afat ligjor të përfunduara jashtë afatit ligjor në vitin 2020 janë çështjet me numër rendor 4, 9, 10, 11, 12, 13 në Tabelën nr. 10; çështjet me numër rendor 1, 3, 4, 5, 6, 22, 27, 30, 33, 37 në Tabelën nr. 11 dhe çështja me nr. 7 në Tabelën nr. 12.

të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Penale seancë parapake” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë” .

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (33 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (77 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 42.85% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin “Mbi mesataren”, duke parashtruar se, gjatë ushtrimit të detyrës është kujdesur të respektojë afatet ligjore, të mos cenohet kontradiktoriteti ndërmjet palëve, mbrojtja efektive, një hetim i plotë dhe i gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjeve apo njoftimi i palëve. Gjyqtarja ka parashtruar se në disa raste ka qenë i pamundur që të respektohet afati për shkaqe të arsyeshme: kërkesa për paraqitje provash; pezullimi i veprimtarisë gjyqësore për shkak të masave anti covid, apo shkaqe të tjera objektive, të pavarura nga gjyqtarja.

Për secilën prej çështjeve që ka rezultuar jashtë afatit ligjor, gjyqtarja ka përcjellë sqarimet e saj me shkresën e datës 16.06.2023, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 2794/1 prot., datë 16.06.2023, ku ndër të tjera evidentohen si shkaqe për shtyrjen e seancës fenomene natyrore si tërmeti 26 nëntor 2019; pandemia e COVID-19 nga data 10.03.2020 deri në datën 27.04.2020; leja vjetore e gjyqtares në muajt gusht të secilit vit, leja vjetore 11.01.2021-15.01.2021; raporti mjekësor i gjyqtares për shkak të izolimit prej infektimit me COVID-19, nga data 01.12.2020 deri në datën 15.12.2020; bllokimi i rrugëve prej ngricave; kërkesa për shtyrje seance të palëve; kërkesa për dhënien kohë për mbrojtje efektive; mosparaqitja e prokurorit; etj.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 33 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se :

(i) Për një çështje¹⁰⁷ me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit”, e cila është gjykuar në afatin prej 35 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 291 i K.Pr.Penale,

¹⁰⁵**Çështjet me afat ligjor të përfunduara brenda afatit ligjor** në vitin 2021 janë çështja me numër rendor 3 në Tabelën nr. 1; çështja me numër rendor 4 në Tabelën nr. 3; çështjet me numër rendor 1-6, 11, 13-16 në Tabelën nr. 10. **Çështjet me afat ligjor të përfunduara jashtë afatit ligjor në vitin 2021**, janë çështjet me numër rendor 7, 8, 9, 10, 12 në Tabelën nr.10; çështjet me numër rendor 2, 5, 6, 7, 13, 17, 18 në Tabelën nr.11.

¹⁰⁶**Çështjet me afat ligjor të përfunduara brenda afatit ligjor** në vitin 2022 janë çështjet me numër rendor 8-12 në Tabelën nr. 3; çështjet me numër rendor 1-8, 10-12 në Tabelën nr. 10. **Çështjet me afat ligjor të përfunduara jashtë afatit ligjor në vitin 2022** janë çështjet me numër rendor 9, 13, 14 në Tabelën nr.10 dhe çështja me numër rendor 28 në Tabelën nr.2.

¹⁰⁷Në tabelën nr. 10 të vitit 2020 çështja me nr. rendor 9

në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, konstatohet se çështja është regjistruar në datën 23.12.2019 dhe vendimi është shpallur në datën 27.01.2020. Pra, për këtë çështje, afati ligjor është tej kaluar me vetëm 5 ditë, duke pasur në vëmendje këtu që çështja është regjistruar në fund të vitit, periudhë kjo që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata, çështje do të konsiderohet se ka përfunduar brenda afatit ligjor.

- Për një çështje¹⁰⁸ me objekt “*Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit*”, e cila është gjykuar në afatin prej 63 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 291 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, konstatohet se është regjistruar në datën 20.07.2020 dhe vendimi është shpallur në datën 21.09.2020. Pra, për këtë çështje, afati ka kaluar me 31 ditë. Duke marrë parasysh lejen vjetore të gjyqtarit gjatë muajit gusht, e cila është 35 ditë, nëse zbresim këtë numër ditësh nga afati i tejkualuar, del se çështja është gjykuar për një afat 28 ditë, e si e tillë do të konsiderohet si e gjykuar brenda afatit.
- Për një çështje¹⁰⁹ me objekt “*Dërgim në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin prej 56 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, konstatohet se është regjistruar në datën 17.08.2020, i është caktuar gjyqtarës me shortin e datës 09.09.2020 dhe vendimi është shpallur në datën 12.10.2020. Nëse afati i gjykimit do të përlllogaritet nga data e caktimi të çështjes me short gjyqtarës atëherë do të rezultonte se afati ligjor është tejkualuar me vetëm 3 ditë, tejkualim ky i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit.
- Për një çështje¹¹⁰ me objekt “*Dërgim në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin prej 42 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, konstatohet se është regjistruar në datën 09.11.2020 dhe vendimi është shpallur në datën 21.12.2020. Pra, për këtë çështje, afati ligjor ka kaluar me 12 ditë, ndërkohë që rezulton që gjyqtarja ka qenë me raport mjekësor për shkak të pandemisë së COVID-19, nga data 01.12.2020 deri në datën 15.12.2020. Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha që gjyqtarja ka qenë me raport, atëherë kjo çështje do të kishte përfunduar për 27 ditë, pra brenda afatit ligjor.
- Për një çështje¹¹¹, me objekt “*Kërkesë për përjashtim gjyqtari*”, e cila referuar të dhënave statistikore dhe Raportit Analitik rezulton se është gjykuar në afatin 1 muaj, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 22 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 48 orë. Nga përmbajtja e sqarimeve shtesë lidhur me formularin e integruar të vlerësimit të përcjellë nga gjyqtarja me shkresën e datës 16.06.2023, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 2794/1 prot., datë 16.06.2023 rezulton se në faqen 14 ka sqaruar se është gabim material, pasi çështja është regjistruar në datën 10.11.2020 dhe është shqyrtuar në datën 11.11.2020. Kjo e dhënë e pretenduar nga gjyqtarja vërtetohet me fletën e

¹⁰⁸Në tabelën nr. 10 të vitit 2020 çështja me nr. rendor 13

¹⁰⁹Në tabelën nr. 11 të vitit 2020 çështja me nr. rendor 30

¹¹⁰Në tabelën nr. 11 të vitit 2020 çështja me nr. rendor 37

¹¹¹Në tabelën nr. 12 çështja me nr. rendor 7

printuar elektronikisht Regjistri i Veprimeve, Numri i Aktit. Për rrjedhojë, çështja rezulton se është gjykuar brenda afatit ligjor dhe si e tillë do të konsiderohet.

- Për një çështje¹¹² me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit”, e cila është gjykuar në afatin prej 57 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 291 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, konstatohet se është shortuar në datën 23.11.2019 dhe vendimi është shpallur në datën 19.01.2021. Pra, për këtë çështje, afati ka kaluar me 27 ditë. Në këtë afat duhet të zbriten datat 01.12.2020-15.12.2020 kur gjyqtarja ka qenë me raport mjekësor për shkak të COVID-19, datat 11.01.2021-17.01.2021 kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore, si dhe procesin e mbartjeve të dosjeve, i cili është i përvitshëm në secilën gjykatë. Duke zbritur këtë afat, atëherë kjo çështje do të konsiderohet si e gjykuar brenda afatit.
- Për një çështje¹¹³, me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 11 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 291 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, nga përmbajtja e sqarimeve shtesë lidhur me formularin e integruar të vlerësimit gjyqtarja në faqen 3 ka sqaruar se çështja në fakt nuk ka pasur objekt “Ankimin ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit”, por pasi është njohur me fashikullin e prokurorit, gjyqtarja ka konstatuar se bëhej fjalë për ankim ndaj vendimit të pushimit, i cili shqyrtohet në dhomë këshillimi. Duke e marrë të bazuar këtë pretendim të gjyqtares, vihet re se ligji procedural penal, neni 329 paragrafi i tretë i K.Pr.Penale, parashikon si afat ligjor, afatin 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, i cili nuk rezulton të jetë respektuar, sepse çështja është gjykuar për 41 ditë. Për rrjedhojë, çështja edhe e trajtuar në këndvështrimin e gjyqtares dhe jo sipas përcaktimeve në të dhënat statistikore dhe Raportin Analitik, rezulton se është jashtë afatit dhe si e tillë do të llogaritet.
- Për një çështje¹¹⁴ me objekt “Dërgim në gjyq”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 16 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, konstatohet se është regjistruar në datën 10.12.2020 dhe vendimi është shpallur në datën 25.01.2021. Pra, për këtë çështje, afati ka kaluar me 16 ditë, ndërkohë që rezulton që gjyqtarja ka qenë me raport mjekësor për shkak të pandemisë së COVID-19, nga data 01.12.2020 deri në datën 15.12.2020 dhe me leje vjetore në datat 11.01.2021 - 15.01.2021. Po ashtu, duhet të mbahen parasysh edhe procesi i mbartjes së dosjeve në gjykatë, i cili është i përvitshëm. Pra, duke zbritur këtë afat, atëherë kjo çështje do të konsiderohet si e gjykuar brenda afatit.

Nga një rillogaritje matematikore e përqindjes së çështjeve të shqyrtuara teji afateve ligjore, duke zbritur nga totali prej 33 çështje, 7 çështjet e mësipërme të cilat konsiderohen në afat, pasi tejkalimi i afatit ka qenë i papërfillshëm ose objektivisht i pashmangshëm, rezulton se kjo përqindje është 33.76% (26 çështje)

¹¹²Në tabelën nr. 10 të vitit 2021 çështja me nr. rendor 7

¹¹³Në tabelën nr. 10 të vitit 2021 çështja me nr. rendor 9

¹¹⁴Në tabelën nr. 11 të vitit 2021 çështja me nr. rendor 6

nga 77 çështje të shqyrtuara tej afatit), përqindje e cila sipas metodologjisë përkon me nivelin e vlerësimit prej 6 (gjashtë) pikësh.

Në Metodologji, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë jo të lartë çështjesh në periudhën e vlerësimit 2 vjet 1 muaj e 5 ditë (01.01.2020 - 06.04.2021 dhe nga data 28.02.2022 -31.12.2022, pasi në periudhën 06.04.2021-28.02.2022 ka qenë me leje barrëlindje), në total ka gjykuar 355 çështje, nga të cilat 197 çështje me palë kundërshtare.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj, duke parashtruar se në këtë pjesë të raportit nuk janë marrë në konsideratë disa çështje për të cilat ligji parashikon afate ligjore, por tejkalimi i afatit ligjor në këto çështje nuk ka ardhur për shkaqe që kanë qenë përgjegjësi e gjyqtares. Gjyqtarja shprehet se çështjet e marrë në analizës prej saj (20 çështje), duhet të konsiderohen në afat, pasi tejkalimi i afatit ka qenë objektivisht i pashmangshëm. Nga ana e saj janë bërë të gjitha përpjekjet për zhvillimin e procesit, duke mos u bërë në asnjë rast shkak për shtyrjen e seancës, kjo edhe duke caktuar seanca çdo javë, atëherë kur procesi i njoftimit e lejonte. Po kështu, gjyqtarja parashtron se duhet marrë në konsideratë se në disa çështje ka disponuar për kthimin e çështjes për hetime, fakti që në një procedim është ndryshuar prokurori dy herë, apo procedura e njoftimit të të pandehurit në mungesë, apo seancat në të cilat prania e prokurorit është e detyrueshme, dhe ky i fundit nuk është paraqitur.

KONKLuzioni

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Për pikëzimin në rastin konkret duke pasur në konsideratë:

- i) ngarkesën e ulët të gjyqtares;
- ii) vetëvlerësimin e gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iii) numrin jo të lartë të çështjeve me afat ligjor, 77 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 21.69% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në periudhën e vlerësimit;
- iv) caktimin e gjyqtares për të gjykuar në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo në të cilën ajo ka ushtruar funksionin gjatë periudhës së vlerësimit, si dhe
- v) argumentet e parashtruar nga gjyqtarja në kundërshtimet e saj;

vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket analizës matematikore dhe konkretisht me 9 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 9 pikë

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 278 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (161 çështje në vitin 2020, 37 çështje në vitin 2021 dhe 80 çështje në vitin 2022), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Familjare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje”, “Seanca paraprake-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se nga 278 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 70¹¹⁵ prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë 25.17% të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit, pasqyruar edhe në raportin analitik, ka referuar se standardi minimal kohor është tejkalar për arsye që lidhen me marrjen e provave; kthimit për hetime shtesë; njoftimin e të pandehurve; njoftimin e palëve me shpallje publike; pezullimi i gjykimit për shkak të mungesës së të pandehurit; leja vjetore; situata e krijuar nga pandemia e COVID 19; etj. Për secilën prej çështjeve që ka rezultuar jashtë afatit ligjor, gjyqtarja ka përcjellë sqarimet e saj me shkresën e datës 16.06.2023, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 2794/1 prot., datë 16.06.2023, ku ndër të tjera evidentohen si shkaqe për shtyrjen e seancës: fenomene natyrore si tërmeti 26 Nëntor 2019; pandemia e COVID-19 nga data 10.03.2020 deri në datën 27.04.2020; leja vjetore e gjyqtarës në muajt gusht të secilit vit; leja vjetore 11.01.2021-15.01.2021; raporti mjekësor i gjyqtarës për shkak të izolimit prej infektimit me COVID 19, nga data 01.12.2020 deri në datën 15.12.2020; bllokimi i rrugëve prej

¹¹⁵47 çështje në viti 2020, 8 çështje në viti 2021 dhe 15 në vitin 202.

ngricave; kërkesa për shtyrje seance të palëve; kërkesa për dhënien kohë për mbrojtje efektive; mosparaqitja e prokurorit; etj.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 70 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja (*muaj gusht i vitit 2020, vitit 2021 dhe viti 2022*), si dhe periudha e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore prej 1 muaj e 17 ditë, për shkak të pandemisë së COVID-19.¹¹⁶ Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore dhe periudha e pezullimit, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

Për kategorinë “Civile me palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështja me numër rendor 8¹¹⁷ (1 çështje) i është caktuar gjyqtarës me short në datën 07.01.2020 dhe ka përfunduar në datën 14.07.2020 (189 ditë). Duke hequr periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID-19 në vitin 2020 (47 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 142 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 9¹¹⁸ (1 çështje), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 13.01.2020 dhe ka përfunduar në datën 29.09.2020 (260 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2020 (35 ditë) dhe periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore (47 ditë) kjo çështje do të kishte përfunduar për 178 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 4¹¹⁹ (1 çështje), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 07.03.2022 dhe ka përfunduar në datën 11.10.2022 (218 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), kjo çështje do të kishte

¹¹⁶Me Vendim Nr. 127, datë 10.03.2020 “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë“ Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-2019.” Me Vendim Nr.128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë“ Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-19...5. Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë për një periudhë 2 (dy) javore duke filluar nga data 25.03.2020 deri me date 07.04.2020.” Me Vendim Nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë“ Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-19. 5. Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë për një periudhë 2 (dy) javore duke filluar nga data 08.04.2020 deri me datë 22.04.2020”. Me Vendimin Nr. 143, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore” Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, më datë 27.04.2020.” Pra, veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar nga data 10.03.2020 deri në datën 27.04.2020, për një periudhë prej 1 muaj e 17 ditë.

¹¹⁷Tabela me nr.1, viti 2020 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹¹⁸Po aty

¹¹⁹Po aty

përfunduar për 183 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë afatin standard prej 6 muaj ose 180 ditë;

Për kategorinë “Civile pa palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 46 dhe 47¹²⁰ (2 çështje), i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin korrik të vitit 2020 dhe kanë përfunduar në muajt nëntor të po këtij viti, përkatësisht për 98 dhe 88 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2020 (35 ditë), çështja me numër rendor 47 do të kishte përfunduar brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare, ndërsa çështja me numër rendor 46 do të kishte përfunduar brenda afatit 63 ditë, duke tejkaluar afatin standard vetëm me 3 ditë, tejkalim i cili konsiderohet i papërfillshëm, në kushtet kur në të kanë ndikuar edhe ditët e pushimit javor.
- çështjet me numër rendor 25 dhe 26¹²¹ (2 çështje), i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin korrik të vitit 2022 dhe kanë përfunduar në muajin shtator të po këtij viti, përkatësisht për 74 dhe 74 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), çështjet do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare, konkretisht për 39 ditë.

Për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështjet me nr. rendor 8, 10, 11, 13, 15, 17, 18¹²² (7 çështje), të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 4 muaj e 6 ditë, 4 muaj e 19 ditë, 4 muaj e 12 ditë, 4 muaj e 21 ditë, 5 muaj e 4 ditë, 4 muaj e 27 ditë, rezulton të jenë regjistruar në muajt janar, shkurt, mars të vitit 2020, dhe gjykimi i tyre ka përfunduar pas rifillimit të veprimtarisë gjyqësore të pezulluar për shkak të pandemisë së COVID-19. Nëse do të zbritej nga periudha e gjykimit, koha e pezullimit prej 47 ditësh, atëherë secila prej këtyre çështjeve do të konsiderohej se kishte përfunduar brenda afatit 120 ditë (4 muaj), konkretisht: 79, 92, 85, 94, 19, 107 dhe 100 ditë.
- çështjet me nr. rendor 20 dhe 21¹²³ (2 çështje), të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 5 muaj e 1 ditë dhe 4 muaj e 27 ditë, rezulton të jenë regjistruar në muajt maj dhe qershor të vitit 2020, dhe gjykimi i tyre ka përfunduar në muajin nëntor të vitit 2020. Nëse do të zbritej nga periudha e gjykimit, koha e lejes vjetore të gjyqtarës, (gusht 2020 prej 35 ditësh), atëherë secila prej këtyre çështjeve do të konsiderohej se kishte përfunduar brenda afatit 120 ditë (4 muaj), konkretisht: 116 dhe 88 ditë.

Për kategorinë “Familjare pa palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështja me nr. rendor 4¹²⁴ (1 çështje), e cila është gjykuar në afatin 2 muaj e 14 ditë, rezulton të jetë regjistruar në muajin korrik të vitit 2020 dhe gjykimi i saj ka përfunduar në muajin tetor të vitit 2020. Nëse do të zbritej nga periudha e gjykimit, koha e lejes vjetore të gjyqtarës (gusht 2020 prej 35 ditësh), atëherë kjo

¹²⁰Tabela me nr.2, viti 2020 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹²¹Po aty

¹²²Tabela me nr.3, viti 2020 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹²³Po aty

¹²⁴Tabela me nr.4, viti 2020 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

çështje do të konsiderohej se kishte përfunduar brenda afatit 60 ditë (2 muaj), konkretisht: 39 ditë.

Për kategorinë “Penale krime”, rezulton se:

- çështja me nr. rendor 5¹²⁵ (1 çështje), e cila është gjykuar në afatin 9 muaj e 24 ditë, rezulton të jetë shortuar në muajin tetor të vitit 2019 dhe gjykimi i saj ka përfunduar në muajin shtator të vitit 2020. Nëse do të zbritej nga periudha e gjykimit, koha e lejes vjetore të gjyqtares (gusht 2020 prej 35 ditësh) dhe koha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID-19 (47 ditë), atëherë kjo çështje do të konsiderohej se kishte përfunduar brenda afatit 270 ditë (9 muaj), konkretisht: 212 ditë.

Për kategorinë “Penale kundërvajtje”, rezulton se:

- çështjet me nr. rendor 3 dhe 6¹²⁶ (2 çështje), të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 5 muaj e 13 ditë, dhe 4 muaj e 23 ditë, rezulton të jenë regjistruar në muajt janar, shkurt, të vitit 2020 dhe gjykimi i tyre ka përfunduar pas rifillimit të veprimtarisë gjyqësore të pezulluar për shkak të pandemisë së COVID-19. Nëse do të zbritej nga periudha e gjykimit, koha e pezullimit prej 47 ditësh, atëherë secila prej këtyre çështjeve do të konsiderohej se kishte përfunduar brenda afatit 120 ditë (4 muaj), konkretisht: 116 dhe 86 ditë.

Për kategorinë “Penale, seancë paraprake”, rezulton se:

- çështja me numër rendor 16¹²⁷ (1 çështje) me objekt “*Kërkesë për pushimin e procedimit penal*”, është regjistruar në datën 28.12.2020 dhe ka përfunduar në datën 02.03.2021, referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 64 ditë. Afatit standard minimal kohor është tejkaluar vetëm me 4 ditë dhe duke pasur në vëmendje këtu që çështja është regjistruar në fund të vitit, periudhë kjo që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata, çështja do të konsiderohet se ka përfunduar brenda standardit minimal kohor.
- çështjet me numër rendor 7 dhe 8¹²⁸ (2 çështje), i janë caktuar gjyqtares me short në muajin qershor dhe korrik të vitit 2022 dhe kanë përfunduar në muajin shtator të po këtij viti, përkatësisht për 77 dhe 67 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), çështjet do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare, konkretisht për 42 dhe 32 ditë.

Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin 23 çështjet e analizuara më sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore, periudha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkaluar me vetëm 1 deri në 7 ditë (i papërfillshëm). Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se nga 278 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 47 prej tyre ose

¹²⁵Tabela me nr.8, viti 2020 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹²⁶Tabela me nr.9, viti 2020 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹²⁷Tabela me nr.11, viti 2021 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

¹²⁸Tabela me nr.11, viti 2022 me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

rreth **16.9% janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 16.9%;
- b) vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- c) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit 2020-2022, ku rezulton se gjyqtarja ka përfunduar 355 çështje, nga të cilat 197 çështje me palë kundërshtare;¹²⁹
- d) natyrën orjentuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësuesit është me e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”;
- e) ngarkesën e ulët të gjyqtarës;

për këtë tregues, në analizë logjike të të dhënave statistikore, gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket analizës matematikore, duke u pikëzuar sipas Metodologjisë, me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht:

- i. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **80.9 ditë**, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **29.49 ditë**, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;

¹²⁹Në pikën 3 shkronja “h” të “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me Standardi sasior i punës parashikohet: **h. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare”.**

- iii. Në kategorinë e çështjeve *“Familjare me palë kundërshtare”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **100 ditë**, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve *“Familjare pa palë kundërshtare”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **96 ditë**, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve *“Marrëdhënie pune”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **123 ditë**, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve *“Penale-krime”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **108 ditë**, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve *“Penale-kundërvajtje”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **97.78 ditë**, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- viii. Në kategorinë e çështjeve *“Seancë paraprake-kërkesë për pushimin e procedimit penal”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **67.8 ditë**, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj, duke e tejkalluar këtë afat me 7.8 ditë (tejkallim i papërfillshëm);
- ix. Në kategorinë e çështjeve *“Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 72.21 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë dhe ka dhënë shpjegime specifike për 19 (nëntëmbëdhjetë) çështje, duke përshkruar specifikat e gjykimit të tyre, që ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat lidhen me: marrjen e provave (akt ekspertimi, akt ekspertimi shtesë), njoftimin e palëve në mungesë, pezullimin e veprimtarisë gjyqësore, ndryshimet e trupit gjykues, kërkesat për shtyrje të palëve, nevoja për ezaurimin e njoftimit të bashkëshortit të paditur për dy seanca pajtimi, etj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 6 nga 9 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për tri nga kategoritë e çështjeve *“Familjare pa palë kundërshtare”*, *“Seancë paraprake – kërkesë për pushimin e procedimit penal”*, dhe *“Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”*, duke u tejkalluar ky afat respektivisht me 36 ditë, 7.8 ditë dhe 12.1 ditë. Bazuar në të njëjtat argumente si për treguesin e *“Plotësimit të standardeve minimale kohore”*, si dhe duke vlerësuar kategorinë e çështjeve për të cilat ky standard rezulton i tejkalluar e kohën e tejkallimit, në analizë logjike të të dhënave statistikore, gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket analizës matematikore, duke u pikëzuar sipas Metodologjisë, me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (355 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik (348 çështje), rezulton 102%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke argumentuar se ky rezultat është shumë i lartë pavarësisht problemeve me njoftimet, sjellja e palëve, mungesës së avokatëve kryesisht apo shkaqeve të tjera që bëheshin shkak për zgjatjen e gjykimeve.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, përqindjes së mësipërme (+99%) i përkon pikëzimi maksimal me 10 pikë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me nivelin maksimal 10 pikë, pasi rendimenti rezulton në masën 102% .

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- (i) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 9.97 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (ii) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 12 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (iii) Për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 14.95 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;

- (iv) Për çështje të kategorisë “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 17.87 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (v) Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsyetimit është 8.87 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (vi) Për çështje të kategorisë “Penale-krime”, koha mesatare e arsyetimit është 16.48 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale;
- (vii) Për çështje të kategorisë “Penale-kundërvajtje”, koha mesatare e arsyetimit është 12.15 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale;
- (viii) Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton, sipas objekti, si vijon:
- kërkesa me objekt “Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 2.64 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale;
 - kërkesa me objekt “Verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe shqyrtim informacioni” “Marrje në pyetje e personit të arrestuar” “Shuarje mase”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 3.33 ditë, **më e gjatë** se afati procedural 48 orë, sipas parashikimeve të nenit 248/2 dhe nenit 261/3 të K.Pr.Penale;
 - kërkesa me objekt “Zëvendësim/revokim mase sigurimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 5.2 ditë, **më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale;
 - kërkesa me objekt “Lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 0 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 24 orë, sipas parashikimeve të nenit 222 të K.Pr.Penale;
 - kërkesa të fazës së hetimit paraprak për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat të posaçëm për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 9.72 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 382/2 të K.Pr.Penale;
- (ix) Për çështje të kategorisë “Seancë paraprake”, koha mesatare e arsyetimit është:
- në çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, 8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale;
 - në çështjet me objekt “Kërkesë për pushim procedimi”, 12.28 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale;
- (x) Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”, koha mesatare e arsyetimit është:
- në kërkesat me objekt “Përrjashtim gjyqtari”, 2 ditë, **pra e barabartë me afatin** procedural 48 orë i parashikuar nga neni 22 i K.Pr.Penale;
 - Për kërkesa me objekt “Rivendosje në afat ankimi” koha mesatare e

arsyetimit është 7 ditë, **pra më i gjatë** sesa afati procedural 5 ditë, i parashikuar nga neni 420/1 i K.Pr.Penale.

- c. në kërkesat të fazës të ekzekutimit për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat të posaçëm për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 19.72 ditë, **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 382/2 të K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se në të gjitha çështjet e mbyllura dhe të arsyetuara prej saj, gjatë periudhës së vlerësimit, vendimet janë arsyetuar për një afat më të shkurtër ose të barabartë me afatin procedural. Sa i takon çështjeve me karakter urgjent, arsyetimi është bërë përherë brenda afatit 24 orë, 48 orë të parashikuar nga ligji. Lidhur me arsyetimin e vendimeve ka theksuar se në disa raste, për shkak se dita e fundit e afatit të arsyetimit ka qenë ditë pushimi apo festë zyrtare, dorëzimi i dosjes dhe hedhja e vendimit në sistem, është bërë në ditën pasardhëse të punës, apo pas përfundimit të lejes vjetore.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se:

- tejkalimi i afatit procedural 48 orë, për nënkategorinë e çështjeve me objekt *“Vleftësim ndalimi/arresti në flagrancë dhe caktim mase”* është me 0.64 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë;
- tejkalimi i afatit procedural 5 ditë, për nënkategorinë e çështjeve me objekt *“Zëvendësim/revokim mase sigurimi”* është me 0.2 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë;
- tejkalimi i afatit procedural 2 ditë, për nënkategorinë e çështjeve me objekt *“Verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe shqyrtim informacioni”* *“Marrje në pyetje e personit të arrestuar”*, *“Shuarje mase sigurimi”* është me 1.33 ditë, një tregues edhe ky i pakonsiderueshëm, duke konsideruar që në përlllogaritje kanë ndikuar edhe pushimet javore;
- tejkalimi i afatit procedural 5 ditë, për çështjet me objekt *“Rivendosje në afat ankimi”*, me 2 ditë, një tregues edhe ky i pakonsiderueshëm, duke konsideruar që në përlllogaritje kanë ndikuar edhe pushimet javore.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si *“Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”*, pasi vetëm për katër nënkategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë tejkaluar me 0.64 ditë, 0.2 ditë, 1.33 ditë dhe 2 ditë, pasur në konsideratë numrin e vendimeve të gjyqtarës për arsyetim, e bën këtë afat të cenuar të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, e në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh,¹³⁰ duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 2 seanca;
- (ii) për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare” është 2.33 seanca;
- (iii) për kategorinë “Penale themeli” është 2 seanca;
- (iv) për kategorinë “Penale seancë paraprake” është 3 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë **2.36 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se Gjyqtarja në përgjithësi ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe si rregull janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Megjithatë, vihet re se Gjyqtarja nuk ka marrë masa në çështjet e zgjidhjes së martesës që akti i ekspertimit ti njoftohet për t’u njohur paraprakisht palëve,¹³¹ në mënyrë që të mos zvarritej gjykimi për shkak të kërkesës së palës për të shtyrë seancën për t’u njohur me aktin e ekspertimit.¹³² Po ashtu, në një çështje me të mitur rezulton se tri seanca janë shtyrë me qëllim njoftimin e psikologut si subjekt i detyrueshëm në proceset gjyqësore me të mitur në konflikt me ligjin.¹³³ Vihet re se Gjyqtarja nuk ka marrë paraprakisht masa për të qenë i pranishëm një psikolog

¹³⁰Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Kavajë, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore për të gjitha çështjet. Për pasojë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit”, numri mesatar i seancave gjyqësore do të përlogaritet duke iu referuar 19 (nëntëmbëdhjetë) çështjeve me palë kundërshtare, të përzgjedhura me short për vlerësim

¹³¹Neni 227 pika 3 i K.Pr.Civile parashikon se: “3. Gjykata fton palët për të tërhequr në sekretari kopjen e tyre të aktit të ekspertimit dhe pasi merr mendimin e palëve, u cakton këtyre të fundit një afat, brenda të cilit ato mund të paraqesin me shkrim mendimet dhe vërejtjet e tyre mbi aktin e ekspertimit”.

¹³²Çështja me nr. 62 regjistri datë 07.02.2020, nr. 52-2020-150 vendimi, datë vendimi 30.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

¹³³Çështja me nr. 12/106 regj., datë regj. 10.12.2020, nr. 52-2021-34, datë vendimi 03.02.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

asistues për të miturin që në seancën e parë, duke urdhëruar në Vendimin për caktimin e seancës paraprake njoftimin dhe praninë e detyrueshme të subjektit psikolog.¹³⁴

Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë gjyqësore, pas ezaurimit të veprimeve përgatitore në çështjet civile dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, vendim për caktimin e seancës paraprake*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *për paraqitjen e provave nga palët ndërgjyqëse; për njoftimin e ekspertës psikologe; për t'i dhënë kohë psikologes të përgatis aktin e ekspertimit; për t'i dhënë kohë palës së paditur të njihet me aktin e ekspertimit; me qëllim njoftimin e viktimave; për njoftimin e psikologut si subjekt i detyrueshëm në proceset gjyqësore me të mitur në konflikt me ligjin; për ti dhënë kohë paditësit të paraqes kërkesë për përjashtim nga tarifat gjyqësore; për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore; për njoftimin e të paditurit me shpallje me afishim publik; për njoftimin e të paditurit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore; për njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht rishtazi në seancë gjyqësore; me qëllim paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim; me qëllim njoftimin efektiv të viktimës person juridik në degën përkatëse; për t'i dhënë kohë paditëses të mbrohet me avokat; për dhënien kohë paditësit të plotësojë të metat e padisë; për njoftimin e të paditurit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore; për shpalljen e vendimit përfundimtar; për përsëritjen e njoftimit për të të paditurin për të marrë pjesë në seancë pajtimi; për njoftimin e të paditurit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. **Katër seanca janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së gjyqtarës për shkak të vetëizolimit prej COVID 19, për arsye familjare, për arsye shëndetësore, për arsye të bllokimit të rrugës nga bora dhe ngrica, etj.** Pra, në përgjithësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.*

KONKLUZIONI

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3 seanca dhe gjyqtarja në përgjithësi ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave.

¹³⁴Neni 18 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon ndër të tjera se : “1. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, aftësia e gjyqtares vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (neni 158/ç i K.Pr.Civile). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda ditës ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenin 329/b për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes për marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive, me përjashtim të një çështje me të mitur, ku rezulton se tri seanca janë shtyrë me qëllim njoftimin e psikologut si subjekt i detyrueshëm në proceset gjyqësore me të mitur në konflikt me ligjin.¹³⁵ Vihet re se gjyqtarja nuk ka marrë paraprakisht masa për të qenë i pranishëm një psikolog asistues për të miturin që në seancën e parë, duke urdhëruar në Vendimin për caktimin e seancës paraprake njoftimin dhe praninë e detyrueshme të subjektit psikolog.¹³⁶ Megjithatë, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Nga ana tjetër evidentohet se gjyqtarja ka respektuar afatet procedurale për caktimin e seancës së parë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon të tilla. Konkretisht për çështjet me objekt “Dërgim në gjyq”, neni 332 i K.Pr.Penale, pika 2 e tij ka përcaktuar se nga data e depozitimit të kërkesës, deri në datën e seancës gjyqësore nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10

¹³⁵Çështja me nr. 12/106 regj., datë regj. 10.12.2020, nr. 52-2021-34, datë vendimi 03.02.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë

¹³⁶Neni 18 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon ndër të tjera se : “1. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme”.

ditë, ndërkohë evidentohet se në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short, me objekt “Dërgimin në gjyq” seanca gjyqësore është caktuar brenda këtij afati ligjor.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa deri në 15 minuta (të papërfillshme), dhe vetëm një numër i kufizuar seancash rezultojnë të kenë filluar me vonesa më tepër se 35 minuta, të diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendëse. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.¹³⁷

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar “Në raport parashtrohet fakti se, në dosjet e marra në vlerësim, në të gjitha rastet nga gjykata janë marrë masat organizative për vendosjen e dosjes në lëvizje, ndërkohë që vetëm në një rast nuk është njoftuar psikologu asistues që në seancën e parë, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.....Gjykata ka proceduar menjëherë me njoftimin dhe paraqitjen e detyrueshme të psikologut asistues, por në gjykatën ku unë ushtroja detyrën, gjithmonë kemi hasur vështirësi për paraqitjen e eksperteve, pasi ato vinin nga larg dhe gjithmonë i parashtronin gjykatës seanca të mëparshme të planifikuara, shkaqe të cilat sillnin shtyrjen e seancave. Megjithatë, mendoj që vetëm ky rast i vetëm nuk mund të ulë vlerësimin tim lidhur me aftësinë për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”.

¹³⁷Përveç çështjeve të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi për të cilat nuk është mbajtur procesverbal për shkak të ritit të shqyrtimi

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer në përgjithësi me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor. Lidhur me mosmarrjen e masave për njoftimin e ekspertit psikolog në një çështje¹³⁸ me të mitur në seancë paraprake, edhe pse parimet e drejtësisë miqësore me të mitur lipsin një gjykim pa vonesa dhe të shpejtë të të miturve, nga shpjegimet e gjyqtarës duket që kjo të ketë ndodhur për shkak të mungesës së psikologut asistues në gjykatën ku ajo ushtronte funksionin (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë). Në kushtet kur gjetjet e konstatuara lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale, kryesisht në çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin, lidhen ngushtësisht me mungesën e psikologut, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja vlerësohet me aftësi “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtarja gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLuzioni

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

¹³⁸Çështja me nr. 12/106 regj., datë 10.12.2020, nr. 52-2021-34 vendimi, datë 03.02.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (kërkesëpatria, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (aktet e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, komunikimet shkresore me të tretët, urdhri/vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare).

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në lidhje me këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitet 2020-2022, ndaj gjyqtarës rezulton të jetë paraqitur 1 (një) ankesë¹³⁹ për të cilën, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me Vendimin nr. 1640/3 datë 04.06.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vendosur arkivimin e saj pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkakun e ankesës dhe rezultatet e verifikimit të saj, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezultonte se ankuesi ngrinte pretendime se gjyqtarja nuk kishte marrë parasysh provat e vëna në dispozicion prej tij. Në vendimin nr. 1640/3 prot., datë 04.06.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndër të tjera arsyetohet se: *“...Nisur nga pretendimet e mësipërme, nga shqyrtimi fillestar i anesës vlerësohet se pretendimet e ankuesit lidhen me “pakënaqësi”, përsa i përket mënyrës së vendimmarrjes nga ana e magjistratëve Z.P.Ç dhe Znj. A.S për zgjidhjen në themel të çështjes. Nga natyra e pretendimeve dhe fakti se çështja në këto raste ka të bëjë me çmuarjen e provave nga organi procedues, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë nuk mund të marrë atributet e një organi tjetër të pavarur kushtetues... Pretendimet e ankuesit ndaj magjistrates znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, gjithashtu janë pretendime të cilat lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimit të provave nga gjykata respektive. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor, është atribut i pushtetit gjyqësor. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe vendimmarrja e gjykatës kontrollohen nga sistemi hierarkik gjyqësor nëpërmjet gjykatave më të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit/rekursit të parashikuara në ligjin e sipërcituar...Nga shqyrtimi fillestar i ankesës dhe pretendimeve të paraqitura konstatohet se sjellja apo veprimet e magjistratëve z. P.Ç dhe znj. {...} me detyrë përkatësisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, nuk janë të natyrës së tillë që të përbëjnë shkelje disiplinore sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.”*

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtarës subjekt vlerësimi.

¹³⁹Sa i përket ankuesit S.P me nr. ankesë 729 prot., datë 20.05.2020, mbi bazën e shkresës nr. 3179 prot., datë 02.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për trajtimin me përparësi të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarëve, të cilët janë në proces vlerësimi etik dhe profesional, me shkresën nr. 1905/1 prot., datë 04.07.2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka informuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se për gjyqtaren {...}, rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave, konkretisht ankues S.P me nr. 729 prot., datë 20.05.2020, pas administrimit të dokumentacionit dhe shqyrtimit fillestar të ankesës, pretendimet e ankuesit S.P nuk lidhen me gjyqtaren {...}.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit i ka vlerësuar shumë të larta aftësitë e saj në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, etika e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarës

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, rezulton të jetë regjistruar pranë ILD 1 (një) ankesë,¹⁴⁰ e trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me Vendimin nr. 1640/3 datë 04.06.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të cilën, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin e saj pas shqyrtimit fillestar, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtëtin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarës {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 1948/3 prot., datë 14.07.2023, rezulton se: *“Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin*

¹⁴⁰Sa i përket ankuesit S.P me nr. ankesë 729 prot., datë 20.05.2020, mbi bazën e shkresës nr. 3179 prot., datë 02.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për trajtimin me përparësi të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarëve, të cilët janë në proces vlerësimi etik dhe profesional, me Shkresën nr. 1905/1 prot., datë 04.07.2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka informuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se për gjyqtarën {...}, rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave, konkretisht ankues S.P me nr. 729 prot., datë 20.05.2020, pas administrimit të dokumentacionit dhe shqyrtimit fillestar të ankesës, pretendimet e ankuesit S.P nuk lidhen me gjyqtarën {...}.

dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë“, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka kryer kontrollin e plotë të deklaratave të interesave privatë, për periudhën 2019-2022 për subjektet si më poshtë: 1. M.K, 2. {...}, 3. A. C. Në përfundim të kontrollit të plotë të deklaratave të interesave privatë “Para fillimit të detyrës 2019- periodike vjetore 2022” për subjektet më sipër, ka rezultuar se: - Deklaratat e interesave privatë “Para fillimit të detyrës 2019- periodike vjetore 2022”, janë dorëzuar brenda afateve ligjore. – Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave privatë janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit. – Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.”

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtares, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2020–31.12.2022, janë paraqitur 2 (dy) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, për të cilat është vendosur rrëzimi i kërkesës. Po kështu, rezulton se vetë gjyqtarja nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë.

KONKLZIONI

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares (zero kërkesa të pranuar), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit për efekt të Metodologjisë vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtaest dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ku numër sipas Metodologjisë është “I pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, marrjen e provave nga të tretët, etj.*) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, presumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares lidhur me këtë tregues, vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë pjesëmarrëse. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë: Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 9 (nëntë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë trajnimi.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 9 aktivitete të zhvilluara për 15 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja nuk është angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses në aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës apo si udhëheqëse për kandidatët gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në

veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses apo udhëheqëse për kandidatët gjyqtarë gjatë stazhit profesional, në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese apo si udhëheqëse për kandidatët gjyqtarë gjatë stazhit profesional, pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për pasojë, pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit (01.01.2020-31.12.2022) në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në formularin e vetëvlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se gjatë periudhës së vlerësimit nuk është angazhuar në veprimtari jashtë funksionit, kjo për faktin se gjatë kësaj kohe ka qenë me leje barrë lindje.

Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si (listë joshteruese): fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislativës; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshme me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Në të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë ndërinstitucionale, duhet të provohet kontributi dhe angazhimi efektiv i gjyqtarit për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Në

këtë kuadër, vetëm pjesëmarrja e gjyqtarit në bordet e shoqatave dhe aktivitetet e mësipërme, nuk përbën veprimtari ndërinstitucionale.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 (zero) pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin "Publikime ligjore akademike" nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit
KRITERI

AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësi të profesionale të gjyqtarës	86	Shumë mirë
2. Aftësi organizative të gjyqtarës	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësi personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	371	Shumë mirë

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, sidomos në tema që lidhen me drejtësinë penale për të mitur, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha. Gjyqtarja duhet t’i kushtojë më shumë kujdes respektimit të afateve ligjore, ndjekjes së një strukture të qëndrueshme dhe të organizuar të vendimit gjyqësor, si dhe saktësisë së dispozitivit të vendimit me qëllim që ai të jetë i qartë dhe i zbatueshëm.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2020 - 31 DHJETOR 2022

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total		Niveli i vlerësimit
			86		Shumë mirë
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mesatare	6	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				94	Shkëlqyeshëm

Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	21-30 %	9	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se

					standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për

					shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1.Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e	a. Rregullshmëria e dokumentacionit	1.Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së

gjqtares për të administruar dosjen gjyqësore	të dosjes	përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares			gjqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Pikët total	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1.Informacioni i marrë nga ILD 2.Dosja personale e gjyqtares 3.Vetëvlerësimi i gjyqtares 4.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë

B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e	Pikët	Metodologjia	

			aftësisë/niveli i treguesit		
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë

					Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtares: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

		tregon ngritjen profesionale të gjyqtares			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			371		
IVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			Shumë mirë		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

